



Adnan Oktar  
HARUN JAHJA

# PARA SE TE PENDOHESH

(I dërguari) tha: "O Zoti im, më ndihmo, sepse  
ata më akuzojnëse gënje!"

(All-llahu) tha: "Së shpejti do të pendohen!"

(Sure Mu'minun: 39-40)



## RRETH AUTORIT



Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ  
رَسُولُهُ  
مُحَمَّدٌ

## PËR LEXUESIN

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshtoi faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e All-llahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e All-llahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

Përveq kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezentimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e All-llahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësoj materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.

# PARA SE TË PENDOHESH

(I dërguari) tha: “O Zoti im, më ndihmo,  
sepse ata më akuzojnë se gënjej!”  
(All-llahu) tha: “Së shpejti do të pendohen!”

(Sure Mu’minun: 39-40)

**HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)**







# PARA SE TË PENDOHESH

*(I dërguari) tha: "O Zoti im, më ndihmo,  
sepse ata më akuzojnëse gënjej!"*

*(All-llahu) tha: "Së shpejti do të  
pendohen!"*

*(Sure Mu'minun: 39-40)*

**HARUN JAHJA**  
**(Adnan Oktar)**





## DY FJALË RRETH AUTORIT DHE VEPRAVE TË TIJ

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi. Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi.

Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane,





Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizojnë librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeya kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

## PËR LEXUESIN

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpëgojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e All-llahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e All-llahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptojt ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

Përveç kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezentimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e All-llahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësojë materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.

Copyright© Harun Yahya

GLOBAL

PUBLISHING

Talatpasa Mah. Emirgazi Caddesi

?brahim Elmas ?s Merkezi

A. Blok Kat 4 Okmeydani - Istanbul

Tel: (0 212) 222 00 88

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in any retrieval system or transmitted in any form or by any methods, electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise without the prior permission of the publishers.

[www.harunyahya.com](http://www.harunyahya.com) - [www.harunyahya.net](http://www.harunyahya.net)

<http://en.harunyahya.tv> - [www.a9.com.tr](http://www.a9.com.tr)



# *Përmbajtje*

TPARATHËNIE .....	10
PENDIMI QË NDJEN NJERIU NË KËTË BOTË .....	14
FILLIMI I PENDIMIT PËR JOBESIMTARËT: VDEKJA .....	28
PENDIMI QË NDIEN NJERIU NË DITËN E GJYKIMIT	38
PENDIMI QË NDIEN NJERIU NË XHEHENNEM (FERR) .....	47
PËR TË MOS NDIER KEQARDHJE NË AHIRET (JETËN E PËRTEJME).....	70
MASHTRIMI I EVOLUCIONIT .....	75

# *Parathënie*



Herë pas here një person përballlet me dhimbje dhe vështirësi të ndryshme fizike dhe shpirtërore në këtë botë. Ndër to janë ndjenjat aq të thella që nuk mund të krahasohen me asnjë dhimbje tjetër fizike. Kjo ndjenjë që shkakton një shqetësim aq të madh në shpirtin e njeriut është një ndjenjë që quhet "pendim."

Megjithatë, ekzistojnë dy forma krejtësisht të ndryshme të pendimit. Pendimi që ndjehet besimtarët dhe pendimi që e përjetojnë jobesimtarët. Këto dy ndjenja dallojnë jashtëzakonisht shumë nga njëra-tjetra.

Besimtarët janë njerëz të cilët kanë një besim absolut në faktin se ngjarjet ndodhin me vullnetin e All-llahut, dhe çdo gjë që u ndodhë atyre, ndodhë me vullnetin e All-llahut. Kjo e shpjegon vetinë e tyre dalluese shumë të rëndësishme të besimit të paepur të tyre në All-llahun,



në kohë të mira, në telashe, ose kur ata bëjnë ndonjë gabim. Profeti Muhammed (savs), vuri në dukje karakterin e fortë të besimtarit me një krahasim në hadithin më poshtë:

*Shembulli i një besimtari është sikurse shembulli i një kalliri që qëndron në fushë e që tronditet nga era dhe pastaj kthehet në gjendjen e tij të parë, por qëndron në rrënjët e tij. (Muslimi)*

Pasi që bën një gabim, një besimtar menjëherë pendo-  
het me sinqeritet dhe shpreson në faljen e All-llahut. Si rezultat, ai nuk vuan nga një ndjenjë e dhimbshme dhe jetëgjatë e pendimit. Pendimi që ndjejnë besimtarët i nxit ata që të kërkojnë falje, për të pastruar veten e tyre dhe i ndalon ata nga përsëritja e këtij gabimi. Kjo i ndihmon ata t'i korrigjojnë gabimet e tyre dhe i ndalon ata të mos zhyten në një gjendje të dhimbshme dhe pesimiste shpirtërore. Për më tepër, ky pendim nuk e zvogëlon entuziazmin, përkushtimin, apo zellin e tyre fetar dhe as nuk i tërheq ata poshtë në një spirale frike dhe depressioni.

Pendimi që ndjejnë jobesimtarët, në anën tjetër, është shumë shqetësues dhe jetëgjatë, pasi që ata nuk kanë besim në All-llahun, kur ata ndeshen me vështirësi ose kur bëjnë ndonjë mëkat. Gjatë gjithë jetës së tyre, ata shpesh përdorin fraza të tilla si "Do të dëshiroja të mos e kisha bërë këtë..." "Do të dëshiroja të mos e kisha thënë

kurrë këtë..." dhe kështu me radhë.

Më e rëndësishme është se ata i nënshtrohen një pendimi shumë më të madh në Ahiret. Ata që kanë jetuar një jetë të larguar prej fesë (dinit) në këtë botë do të pendohen për çdo moment të jetës së tyre që e kanë jetuar të larguar nga rruga e drejtë. Ata ishin paralajmëruar më parë dhe ishin ftuar në rrugën e drejtë. Ata patën kohë të mjaftueshme për të menduar dhe për të zgjedhur rrugën e drejtë. E megjithatë, ata nuk dëgjuan, kur u paralajmëruan, duke shpërfillur Ahiretin sikur kurrë nuk do të vdisnin. Pastaj në botën tjetër, ata nuk do të kenë mundësi të kthehen në këtë botë dhe t'i korrigjojnë gabimet e tyre. Në Kur'an, All-llahu i rrëfen shprehjet e tyre plot keqardhje si vijon:

**Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: "Ah, sikur të isha pluhur!" (Sure Nebe: 40)**

**Sikur t'i shohësh ata kur të vihen para zjarrit, duke thënë: "Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t'i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!" (Sure En'am: 27)**

**Ata do të thonë: "Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!" (Sure Mulk: 10)**



Ky libër ka për qëllim t'i paralajmëroj njerëzit për një ditë kur ata do të pendohen duke thënë "ah, sikur të kishim kuptuar...", "ah, sikur të mos i kishim refuzuar shenjat e Zotit tonë...", "ah, sikur t'i kishim pasuar ata të cilët na sollën porosinë...", "ah, sikur ta kishim bërë këtë dhe atë," etj dhe t'i ftojë ata që të jetojnë për All-llahun, ndërsa ende e kanë mundësinë për t'i korrigjuar gabimet e tyre.

Mbani në mend se atë ditë pendimi i askujt nuk do ta shpëtojë atë nga zemërimi i All-llahut. E vetmja mënyrë për t'iu shmangur këtij pendimi është që t'i nënshtrohem All-llahut, ndërsa ka ende kohë dhe t'iu bindemi urdhërave të All-llahut.

Ky libër është një ftesë për në rrugën e All-llahut dhe një përkujtim për ndëshkimin e pashmangshëm në botën tjetër, ku nuk do të ketë vend për t'u fshehur dhe asnjë mundësi shpëtimi. All-llahu na përkujton këtë fakt në Kur'an në këtë mënyrë:

**Përgjigjuni thirrjes së Zotit tuaj, para se të vijë Dita, të cilën All-llahu nuk e kthen më. Atë Ditë ju nuk do të keni kurrfarë strehimi dhe nuk do të mund të mohoni. (Sure Shura: 47)**

# *Pendimi që ndjenë njeriu në këtë botë*



*Xthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij, para se t'ju vijë dëntimi, sepse atëherë nuk do të mund t'ju ndihmojë kush. Ndiqni më të mirën e asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë dëntimi papritmas, pa e ndier atë. (Sure Zumer: 54-55)*

Kur njeriu është në rrezik jete, "ndërgjegjja" e tij fillon ta bëjë një vlerësim të shpejtë të jetës dhe veprave të tij. Nëse ky person nuk ka jetuar në pajtim me fenë (dinin) e All-llahut dhe nuk është angazhuar në vepra të mira në këtë botë, atëherë ai do të jetë i pushtuar nga pikëllimi dhe një pendim i madh. Shumë gjëra që ishin lënë pas dore gjatë jetës së tij shfaqen papritmas dhe me qartësi para syve të tij. Ndoshta për herë të parë në jetën e tij, ai

e kupton se sa afër është vdekja. Ai pranon se nuk ka bërë një jetë të kësaj bote që i jep atij të drejtën për Xhennet. Ai bëhet i vetëdijshtëm se ka qenë mosmirënjohës ndaj All-llahut dhe ndjen se kjo nuk do të mbetet pa përgjigje. Një frikë e tmerrshme të cilën nuk e ka përjetuar kurrë më parë e rrethon atë, dhe e kupton se vetëm All-llahu mund ta shpëtojë atë nga gjendja në të cilën ndodhet. Pastaj, ai i premtton All-llahut se do të vazhdojë të jetë mirënjohës dhe i drejtë dhe se gjithmonë do ta kujtojë këtë gjendje. Ai i lutet All-llahut në mënyrë të sinqertë që të jetë i shpëtuar nga rreziku në të cilin ndodhet. Ai kërkon vetëm që të shpëtojë dhe t'i jepet vetëm një mundësi për të mbetur gjallë...

Megjithatë, ca njerëz nuk u mbeten besnik fjalëve dhe premtimeve që më parë i kishin dhënë All-llahut pasi që mbijetojnë një rrezik të tillë për jetë. Posa All-llahu e shpëton një person të tillë, ai kthehet në gjendjen e tij të mëparshme. Ndjenjat e pendimit dhe të nënshtrimit zëvendësohen me ndjenjën e mosmirënjohjes. Ai harron atë që kishte menduar dhe kuptuar në momentin kur ishte përballur me vdekjen. Me besimin se e kishte kaluar rrezikun, ai largohet nga All-llahu sikur të mos ishte ai personi që kishte përjetuar pendimin dhe që i ishte përgjyruar me sinqeritet All-llahut më parë. Ai e vazhdon jetën e tij me një dashuri edhe më të madhe për botën, sikur të mos kishte qenë në një situatë të vështirë pak kohë më parë. Në Kur'an, disa shembuj e përshkruajnë



gjendjen psikologjike të njerëzve të tillë:

**Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhi dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t'i vënë poshtë, (atëherë) i luten All-llahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: "Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës". E kur All-llahu i shpëton ata, ata përnjëherë pa kurrfarë të drejte bëjnë turbullira në Tokë. O njerëz! Vërtet, padrejtësia që bëni për t'u kënaqur në jetën e kësaj bote, vetëm ju dëmton. Pastaj ju do të ktheheni te Ne dhe Ne do t'ju njoftojmë për atë që keni punuar.(Sure Junus: 22-23)**

**Kur juve ju godet fatkeqësia në det, ata që ju i adhuronit në vend të Atij, zhduken. Por, pasi Ai ju shpëton në tokë, ju i ktheni shpinën. Njeriu është mosmirënjohës. Vallë, a jeni të sigurt, që Ai nuk do t'ju fundosë në tokë ose, që nuk do të dërgojë mbi ju stuhi me rërë, pa pasur mundësi që ju të gjeni dikë, që t'ju mbrojë? (Sure Isra: 67-68 )**

Siç theksohet në ajetin e mësipërm, si mund të jetë i sigurt njeriu se nuk do të përballë përsëri me një rrezik të ngjashëm apo krejtësisht tjetër? Përndryshe, si mund të ndjehet dikush i sigurt se do të shpëtojë një herë tjetër? Nuk ka dyshim se askush kurrë nuk do të mund të garan-

tonte që këto gjëra nuk do të ndodhin. Mbani në mend gjithashtu se shpëtimi nga një rrezik nuk do të përbëjë ndonjë ndryshim në jetën e njeriut. Në fund të fundit, njeriu do të vdes një ditë, pikërisht atëherë kur ai ta mbarojë kohën e përcaktuar për të. Atëherë ai do të ndjehet pendim, por kjo nuk do t'i sjellë aspak dobi atij.

E tillë është gjendja e përgjithshme psikologjike e atyre që jetojnë të larguar nga feja (dini). All-llahu e shpjegon këtë gjendje si vijon:

**E, kur njeriun e gjen e keqja, atëherë Na lutet shtrirë ose ulur, ose në këmbë. E, sapo Ne ia largojmë të keqen, vazhdon rrugën, thujse nuk Na është lutur për fatkeqësinë që e ka goditur. Kështu, plëngprishësve (që shkelin kufijtë e All-llahut) i zbukurohet ajo që punojnë.(Sure Junus: 12)**

**Kur njerëzit i godet ndonjë e keqe, ata i luten Zotit të vet, duke iu kthyer me pendesë, e pastaj, kur Ai u jep të shijojnë mëshirën e Tij, atëherë një pjesë tyre i shoqërojnë Zotit të vet diçka tjetër (në adhurim).(Sure Rum: 33)**

Njerëzit që përshkruhen në këto vargje i drejtohen All-llahut kur ballafaqohen me vështirësi. Megjithatë, posa ta kalojnë këtë vështirësi ata i harrojnë premtimet që i bënë All-llahut dhe shfaqin mosmirënjohje. Ky qëndrim sqaron se pendimi që ata ndjenë në të vërtetë lindi nga pafuqia që ndjen njeriu në gjendje vështirësie.

Pendimi i veçantë për besimtarët megjithatë është shumë i ndryshëm nga pendimi i përmendur më lart sepse ai i sjell më të mirën njeriut. Pendimi i sinqertë nuk harrohet menjëherë. Ai i jep shtytje njeriut dhe shkakton ndryshime thelbësore në karakterin e tij. Ai i cili ndjen pendim të sinqertë në zemrën e tij jeton pjesën tjetër të jetës së tij në pajtim me pëlqimin e All-llahut, duke shpresuar në mëshirën dhe faljen e All-llahut. Kur ndryshojnë rrethanat, ose jepet një mundësi e re, ai nuk guxon kurrë t'i kthehet mënyrës së mëparshme të të jetuarit, duke qenë i vetëdijshëm se një mosmirënjohje e tillë nënkupton humbje për të.

All-llahu në Kur'an rrëfen për gjendjen psikologjike të njerëzve që përballen me vdekjen në bordin e anijes në mënyrë që kjo të shërbejë si paralajmërim për të gjithë njerëzit. Kjo për arsye se kjo prirje ekziston në unin e secilit individ. Pra, duke nxjerrë një mësim nga ky shembull i përshkruar në ajetet e mësipërme, njeriu duhet seriozisht t'i shmangët këtij aspekti negativ të shpirtit të tij dhe të bëjë një verifikim të sinqertë të ndërgjegjes së tij. Pastaj, ai duhet t'ia parashtrojë vetes së tij këto pyetje:

"Në çfarë gjendje psikologjike do të isha, po të isha në një situatë të ngjashme? Çfarë do të më bënte të pendohe-sha? Cilat ndryshime radikale të karakterit tim do t'ia premtoja vetes sime, nëse do të shpëtoja nga rreziku? Prej çfarë veprash do të hiqja dorë dhe cilat vendime do t'i zbatoja sinqerisht në praktikë?"



Të marrësh parasysht këto dhe të veprosh në përputhje me rrethanat, duke qenë fizikisht në rrezik nuk është medoemos e nevojshme. Ka shumë mundësi që dikush që dështon të marr në konsideratë një mundësi të tillë të mund ta përjetojë atë shumë shpejt. Ose, ai mund të mos përballet kurrë me një rrezik të tillë në jetë. Megjithatë, në të dyja rastet një gjë është e sigurtë: kur të vijë momenti i vdekjes i përcaktuar për një person, ai do t'i gjejë papritur engjëjt e vdekjes pranë tij. Mu në atë moment, kur ai vërtetohet plotësisht për të vërtetën e vdekjes, nëse ka dështuar ta jetojë jetën e tij në rrugën e All-llahut, ai patjetër do të ketë arsye për t'u penduar.

Për t'iu shmangur pendimit në këtë botë dhe në botën tjetër, e vetmja gjë që duhet të bëjmë është që t'i kthehemi All-llahut, të jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë tona ndaj All-llahut, dhe t'iu përmbahemi urdhërave të All-llahut siç thuhet në Kur'an. Vdekja është tejet afër, kështu që njeriu nuk duhet kurrë të vonojë për të bërë gjërat për të cilat mban përgjegjësi. Ai duhet t'i vërë në veprim vendimet e tij të sinqerta me durim dhe vendosmëri. Sinqeriteti dhe afërsia me All-llahun duhet të jetë sinqeriteti që ndjen njeriu në kohë rreziku dhe pafuqie, nëse jo më shumë.

Fakti më i rëndësishëm që duhet të mbajmë në mend është fakti në vazhdim: qëllimi kryesor i ekzistencës së njeriut në këtë botë është që t'i shërbej All-llahut dhe të jetë një rob që fiton kënaqësinë e Tij. Çdo gjë tjetër përveç

kësaj, domethënë, sukcesi, pasuria, familja, karriera e njeriut, etj janë vetëm mjete me të cilat njeriu mund t'i afrohet më shumë All-llahut. Përpjekjet e atyre që përpiqen vetëm për t'i arritur ato mjete në mënyrë të pandërgjegjshme, duke harruar dhe shpërfillur faktin se këto të mira u janë dhënë atyre nga All-llahu në mënyrë që ata t'i kthehen Atij dhe t'i falënderohen Atij, do të jenë të kota, përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe. Përfitimet e përkohshme të realizuara në këtë botë mund të mos i bëjnë fare dobi njeriut në botën tjetër. Në Kur'an, Zoti ynë i Plotfuqishëm All-llahu thotë se këta janë soji i njerëzve të cilët do t'i pllakosë më së shumti pikëllimi:

**Thuj:** "A doni t'ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?" Këta janë ata, që nuk kanë besuar në shpalljet e Zotit të tyre dhe në takimin me Të. Punët e tyre do të fshihen, andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta (për veprat e tyre), në Ditën e Kiametit. (Sure Kehf: 103-105)

Nëse njeriu e fiton kënaqësinë e All-llahut në këtë botë nëpërmjet sjelljes dhe moralit të tij, All-llahu me siguri do ta mbrojë atë si në këtë botë ashtu edhe në të përtejmen. Megjithatë, nëse ai e humb këtë mundësi në këtë botë, ai do të pendohet për këtë gabim të tmerrshëm që nga momenti kur engjëjt e vdekjes do t'i shfaqen atij. Ky

gabim, që nuk ka gjasa që të përmirësohet, do të jetë shkaku i një pendimi të përjetshëm-përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe. Në Kur'an, All-llahu e përshkruan pendimin që ndjehet njerëzit në Praninë e Tij si vijon:

**Ai do të thotë: "Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!" (Sure Fexhr: 24)**

**...Ai thërriste: "Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!" (Sure Kehf: 42)**

**..."Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! (Sure Furkan: 27)**

Një person i cili nuk do të donte t'i shqiptonte këto fjalë i dëshpëruar duhet, që nga ky moment, t'i nënshtrohet Zotit tonë dhe të jetojë në pajtim me parimet e përcaktuara nga Krijuesi ynë.

### **Njeriu duhet të marrë mësim nga pendimi që ndjenë në këtë botë**

Jeta e kësaj bote është një mundësi e rëndësishme që i është dhuruar njeriut në mënyrë që njeriu të mund të fitojë jetën e përsosur dhe të përjetshme të Ahiretit.

Ata të cilët nuk e shfrytëzojnë këtë mundësi dhe jetojnë një jetë shumë të largët nga feja Islame do të pendohen për çdo moment që e kanë jetuar në dynja, kur ta shohin dënimin në Ahiret. Kjo për shkak të faktit se këta njerëz ishin paralajmëruar disa herë dhe ishin bërë me dije për ekzistencën e të dy bane-



**save të Xhehennemit dhe Xhennetit. Ata ishin bërë me dije gjithashtu se sjellja e tyre do të përcaktonte se cilën banesë do ta fitojnë, ashtu siç ka thënë Pejgamberi (savs): "Dy njaja është ara e Ahiretit." (Ihja 'el-ulum, iv, 14.)**

All-llahu me zemërgjerësi të madhe e mëson njerëzimin për ndjenjën e pendimit në këtë botë duke i stimuluar mendimet dhe ndjesitë e njeriut nëpërmjet përvojës së pendimit, në mënyrë që ai të mund të shmang arritjen e këtij fundi të pakthyeshem. Përveç kësaj, All-llahu u jep njerëzve një kohë të caktuar në mënyrë që ata të mund ta pastrojnë veten nga gabimet e tyre dhe sjelljet e tyre të gabueshme. Gjatë jetës, çdo qenie njerëzore i është ofruar mundësia për t'u penduar dhe për ta jetuar pjesën e mbetur të jetës së tij në rrugën e All-llahut.

Shikuar nga ky këndvështrim, ndjenja e pendimit është në të vërtetë një mundësi e madhe që All-llahu ia dhuron njeriut. Kjo për arsye se pas një pendimi të tillë të thellë, nëse njeriu i kthehet All-llahut, All-llahu i dhuron atij shpëtimin e përjetshëm si shpërblim për sinqeritetin e tij. Në anën tjetër, nëse njeriu i shpërfill në mënyrë të shkurtesur këto paralajmërime dhe mundësi, atëherë dënimi i tij do të jetë pendimi dhe pikëllimi nga të cilat ai nuk do të jetë në gjendje të shpëtojë përveç nëse All-llahu ashtu dëshiron.

Në Kur'an, All-llahu na ofron shembuj të ndryshëm të njerëzve që u penduan për gabimet e tyre. Këto ndjenja

pendimi shtynë një grup njerëzish që t'i kthehen All-llahut dhe i shpëtuan ata nga përsëritja e gabimit të tyre për pjesën e mbetur të jetës së tyre. Megjithatë, një grup tjetër me kohë harroi krejtësisht për këtë pendim, dhe nga padituria e përsëritur, u kthyen në gjendjen e tyre të mëparshme të mosbindjes.

All-llahu na njofton në Kur'an për pendimin që përjetuan tre njerëz që nuk kishin marrë pjesë në një betejë gjatë jetës së Profetit Muhammed (savs) si një shembull shumë i përshtatshëm për pendimin që buron nga keqardhja:

**Pa dyshim, All-llahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve, të cilët shkuan pas atij në çastin e vështirë, pasi zemrat e disave prej tyre për një fije qenë afër shmangies (nga detyra), pastaj All-llahu pranoi pendimin e tyre. Vërtet, Ai është i Butë dhe i Mëshirshëm me ta. Ai ua pranoi pendimin edhe atyre të treve, që mbetën prapa atëherë, kur toka, sado e gjerë, iu duk e ngushtë dhe iu shtrënguan shpirtrat, aq sa u bindën se nuk ka strehim tjetër përveç All-llahut e pastaj All-llahu u dha mëshirë që të pendohen. Me të vërtetë, All-llahu pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë. (Sure Teube: 117-118)**

Siç mësojmë nga vargjet e mësipërme, të tre njerëzit që kishin mbetur prapa përjetuan një ndjenjë të madhe të keqardhjes në zemrat e tyre. Si pasojë, ata e kuptuan se e vetmja mënyrë për të

shpëtuar nga kjo keqardhje është që të pendohen dhe të kërkojnë strehim tek All-llahu. Kjo është ndjenja e pendimit të sinqertë që i vë njerëzit në lëvizje, i ndryshon ata dhe i nxit ata për t'i korrigjuar gabimet e tyre. Njerëz të tillë të sinqertë do të jetojnë një jetë në përputhje me pëlqimin e All-llahut dhe do të shpresojnë në dhembshurinë dhe mëshirën e All-llahut. All-llahu na njofton në Kur'an se Ai pranon pa dyshim pendimin e robërve të Tij dhe i falë ata:

**Përrjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë All-llahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. All-llahu është Falës e Mëshirëplotë. Ndërsa, ai që pendohet dhe bën vepra të mira, është i kthyer krejtësisht nga All-llahu. (Sure Furkan: 70-71)**

**Ndërsa ata që kryejnë vepra të këqija e pastaj pendohen dhe bëhen besimtarë, ta dinë se pas kësaj, Zoti yt është vërtet Falës e Mëshirëplotë. (Sure A'raf: 153)**

**O bijtë e Izraelit, Ne ju shpëtuam nga armiku juaj, bëmë besëlidhje me ju në anën e djathtë të Turit dhe ju zbritëm manë dhe thëllëza. (Sure Ta Ha: 82)**

Gjithashtu në Kur'an thuhet se ata popuj të cilëve u janë dërguar profetët u penduan për veprimet e tyre të gabuara. Po ashtu, populli i Profetit Musa (as) që nuk mundën të prisnin që ai të kthehej nga mali Sinai me porosinë e All-llahut e harruan All-llahun dhe iu rikthyen idhujtarisë. All-llahu përshkruan pendimin e madh të këtij populli për gjynahun e tyre si vijon:

Populli i Musait, pas largimit të tij, filloi të adhurojë një viç të



bërë nga stolisjet e tyre të arta. Ai kishte një zë si të lopës. A nuk e shihnin ata se ai as nuk mund t'u fliste, as t'i udhëzonte në rrugë të drejtë?! Ata e zgjodhën këtë viç për adhurim dhe u bënë keqberës. Por, kur u penduan dhe e kuptuan se kishin hyrë në rrugë të gabuar, ata thanë: "Nëse Zoti ynë nuk na mëshiron dhe nuk na fal, me të vërtetë, do të jemi të humbur!" (Sure A'raf: 148-149)

All-llahu e vë theksin në pendim përsëri në Kur'an në historinë e pronarëve të kopshtit. All-llahu u dhuroi atyre një kopsht si mirësi prej Tij. Megjithatë, ata u bënë kryelart, e përvetësuan kopshtin dhe harruan të jenë mirënjohës ndaj All-llahut. Prandaj dënimi që morën bëri që ata të pendohen për veprimet e tyre dhe t'i kthehen All-llahut. Ajetet lidhur me pronarët e kopshtit janë si vijon:

Ne i kemi vënë në provë ata (banorët e Mekës), ashtu siç i sprovuam të zotët e kopshtit, të cilët ishin betuar se në mëngjes do t'i vilnin frutat e nuk patën thënë "Në dashtë Zoti"! Kështu, kopshtin e goditi një fatkeqësi nga Zoti yt, ndërkohë që ata po flinin dhe gdhiu si i kositur. Në agim, ata thirrën njëri-tjetrin: "Nxitoni herët në kopshtin tuaj, nëse doni t'i vilni frutat!" Dhe u nisën duke pëshpëritur: "Të mos lejojmë asnjë të vobekët që të hyjë në kopshtin tonë!" Ata u nisën herët, të vendosur në atë që thanë. Por, kur e panë kopshtin, ata thanë: "Ne qenkemi vërtet të humbur; madje, qenkemi të privuar (nga frutat e kopshtit)." Më i arsyeshmi ndër ta tha: "A nuk ju thashë unë se duhet ta lartësoni All-llahun?!" "Lavdëruar qoftë Zoti ynë! - thanë -

**Ne paskemi qenë vërtet të padrejtë!” Atëherë filluan të qortojnë njëri-tjetrin. “Ah, të mjerët ne! - thanë ata - Paskemi qenë vërtet arrogantë! Zoti ynë mund të na japë një kopësht më të mirë, po të kthehemi të penduar tek Ai!” (Sure Kalem: 17-32)**

Por kur ndryshojnë rrethanat apo kur atyre u jepet një mundësi e re, shumica e njerëzve e harrojnë paralajmërimin, i cili do të duhej t'i bëjë ata të ndjejnë keqardhje, të pendohen dhe t'i inkurajojë ata të bëjnë vepra të mira. Ata që i shpërfillin paralajmërimet dhe u kthehen sjelljeve të tyre të mëparshme me siguri do të dënohen, përveç nëse pendohen me kohë siç ishte rasti me popullin e Themudit, popullin e Profetit Salih (as). Këta njerëz i refuzuan me vrazhdësi paralajmërimet e profetit Salih (as), edhe pse e dinin se do të pendoheshin për dënimin e pashmangshëm të tyre. S'ka dyshim se All-llahu nuk do ta shkel kurrë premtimin e Vet për realizimin e urdhërit të Tij. All-llahu na njofton në Kur'an për këtë të vërtetë, e cila do të jetë një mësim për të gjithë njerëzit:

**Ai tha: “Ja, kjo është një deve. Ajo do të ketë radhën e saj për të pirë, ashtu si edhe ju, në ditë të caktuara. Mos i bëni kurfarë të keqeje asaj, se do t'ju godasë dënimi i një Dite të madhe! Por ata e therën e pastaj u erdhi keq. Dhe kështu, ata i goditi dënimi. Njëmend, në këtë ka këshillë, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë. Në të vërtetë, Zoti yt është i Plotfuqishëm dhe Mëshirëplotë. (Sure Shu'ara: 155-159)**

Njeriu duhet të mbaj mend se All-llahu është i drejtë. Ai nuk


lë asnjë faj pa përgjigje; por Ai gjithashtu shpërblen me bujari të madhe veprat e mira që bëhen për Të. Ai u jep lajmin e gëzuar të mëshirës dhe të Xhennetit të Tij atyre që i kthehen Atij me një pendim të sinqertë. Duke i marrë këto parasysh, njeriu duhet t'ia bëjë vetes pyetjen në vazhdim: duke qenë të vetëdijshëm për telashet e mëdha që shkakton pendimi i përkohshëm në këtë botë, a ia vlen të rrezikohet një pendim që mund të zgjasë përgjithmonë? Mos të harrojmë se ky pendim do të jetë pendimi që njeriu do ta vuajë në jetën e përtejme të pafund në Xhehennem...

Pa dyshim, askush nuk do të rrezikonte të ndjente një pendim të tillë në Ahiret. Në këtë rast, ajo që njeriu duhet të bëjë është e qartë: çdo njeri më vete në këtë botë ka ende kohë për ta shfrytëzuar këtë mundësi. Ai i cili përfiton nga kjo mirësi e All-llahut jo vetëm që do të jetë i shpëtuar nga zjarri por gjithashtu do të jetë trashëgimtar i mirësive të kësaj bote dhe të Ahiretit të përjetshëm.

Prandaj, çdo person i cili përpiqet për t'i arritur këto mirësi dhe për t'iu shmangur pendimit të Banorëve të Zjarrit ka nevojë të jetë i përkushtuar për të fituar kënaqësinë e All-llahut. Njeriu duhet ta ndjekë në mënyrë të pakushtëzuar rrugën që e nxjerr njeriun nga errësira në dritë. All-llahu e përcakton këtë rrugë në ajetet e mëposhtme:

**Është Ai që ju bekon, ndërkohë që engjëjt e Tij luten për ju, me qëllim që Ai t'ju nxjerrë nga errësira në dritë. Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve. Përshëndetja e tyre, kur ta takojnë Atë, është "Paqe". Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar. (Sure Ahzab: 43-44)**

# *Fillimi i pendimit për jobesimtarët: Vdekja*



Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.  
(Sure Enbija': 35)

Vdekja konsiderohet të jetë një fund dhe shkatërrim përfundimtar prej atyre që nuk besojnë në botën tjetër. Mirëpo, ky është një perceptim i gabueshëm ngase vdekja nuk është fundi por një fillim. Për besimtarët, ajo është fillimi i një Parajse të përsosur e të përhjetshme që është e pastër nga çdo e keqe dhe e metë. Për jobesimtarët, në anën tjetër, ky është një kalim në një jetë në Xhehennem, ku përjetohet një dënim i madh.

Ata të cilët e kuptojnë këtë realitet e jetojnë një fund të



këndshëm në këtë botë kur t'ju vijë vdekja dhe një fillim të këndshëm në Ahiret. Këto të dyja ndodhin njëkohësisht. Jobesimtarët, në anën tjetër, përballen me një pendim të pariparueshëm për shkak të mospërfilljes së këtij realiteti, për të cilin ata ishin njoftuar më parë. Ata vuajnë këtë pendim në çdo moment për aq kohë sa të dojë All-llahu dhe kurrë nuk gjejnë pushim prej tij.

Megjithëse vdekja nuk është një çështje të cilës shumica e njerëzve i kushtojnë kujdes të veçantë, ajo është një fund i pashmangshëm. Kjo për arsye se All-llahu e krijon vdekjen si fundin e përcaktuar të kësaj jete. Deri tani, as edhe një person i vetëm nuk i është shmangur vdekjes. Askujt nuk i kanë siguruar prona, pasuria, karriera apo miqtë e ngushtë shpëtimin nga vdekja. Pa dyshim se çdo njeri do ta takojë vdekjen. All-llahu e rrëfen këtë të vërtetë në shumë ajete në Kur'an:

**Kudo që të gjendeni, do t'ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!" (Sure Nisa': 78)**

**Thuaj: "Vdekja prej së cilës po ikni, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t'ju njoftojë ju për atë që keni bërë." (Sure Xhumu'a: 8)**

**Por All-llahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha (evdekjes); All-llahu e di mirë gjithçka që bëni ju. (Sure Munafikun: 11)**

Pra, a e shpëton njeriun shmangja nga të menduarit për

vdekjen dhe për jetën pas vdekjes nga përballja me këtë realitet? Natyrisht se përgjigja në këtë pyetje është "Jo". Pasi që njeriu është i pafuqishëm kur bëhet fjalë për vdekjen, gjëja më e arsyeshme që duhet të bëjë është që vazhdimisht të mendojë për vdekjen dhe të përgatitet për jetën e përtejme, siç ka thënë Profeti Muhammed (savs): "Meditoni shumë për vdekjen. All-llahu ia hap zemrën atij personi i cili mendon shumë për vdekjen dhe e bën vdekjen të lehtë për të." (Transmetuar nga Ebu Hurejra)

Ata që lënë pas dore të menduarit për Ahiretin ndërsa hutohen nga kjo jetë kalimtare e kësaj bote i zë vdekja në befasi. Atyre që thonë: "Derisa jemi të rinj, mund të jetojmë jetën tonë siç na pëlqen më së tepërmi dhe të mendojmë për vdekjen në vitet e fundit të jetës sonë" e kuptojnë se kurrë nuk do të kenë një mundësi të tillë. Kjo për arsye se vdekja është e paracaktuar nga All-llahu. Një person mund të vdes para se të plakët. Në këtë rast, bërja e planeve për të ardhmen dhe shtyrja e përmbushjes së urdhërave të All-llahut do të çojë vetëm drejt një pendimi të tmerrshëm.

Ata që kalojnë jetët e tyre të larguar prej All-llahut dhe të cilët pendohen vetëm kur e kuptojnë se vdekja ju është afruar do të përjetojnë një pendim të tillë. Megjithatë, pendimi që lind nga frika e vdekjes dhe i cili nuk bart një qëllim të sinqertë për të përmirësuar dhe pastruar veten e tij mund të mos jetë i pranueshëm nga All-llahu. Duke qenë haptazi në favor të kësaj jete me gjithë ekzistencën e vdekjes, njerëzit e tillë përpiqen në mënyrë të dëshpëruar për të shpëtuar

veten e tyre vetëm atëherë kur e kuptojnë se vdekja është shumë afër. Mirëpo, kjo nuk u sjell dobi. All-llahu e di josinqeritetin e tyre, sepse All-llahu është më afër njeriut se sa damari i qafës së tij. Ai e di se çfarë ka në brendinë e njeriut, duke përfshirë edhe mendimet e tij më intime dhe sekretet më të thella të tij. All-llahu na bën me dije në Kur'an se Ai nuk do të pranojë pendimin e bazuar në frikën nga vdekja në momentin e fundit:

**Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: "Unë tani me të vërtetë po pendothem". As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm. (Sure Nisa': 18)**

Në shumë vargje është theksuar se kur u jepet një mundësi tjetër, këta njerëz të pasinqertë shpejt vazhdojnë me qëndrimin e tyre mosmirënjohës:

**Sikur t'i shohësh ata kur të vihen para zjarrit, duke thënë: "Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t'i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!" Po, atyre iu doli sheshit ajo që më parë e fshihnin, por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënin ato që u ishin ndaluar. Vërtet, ata janë gënjeshtarë. (Sure En'am: 27-28)**

Për këtë arsye, do të ishte e gabuar të kemi një arsyetim që bazohet në mendimin "Do të pendothem, kur të vijë koha e duhur." Kjo mënyrë e të menduarit nuk do ta shpëtojë njeriun nga dënimi në Xhehennem. Pra, nëse njeriu nuk do

të vuajë një dënim të dhembshëm të përjetshëm pas vdekjes, ai duhet të jetojë për një qëllim, duke e ditur se patjetër do ta takojë All-llahun dhe do të duhet të jap llogari për veprimet e tij.

## **Pendimi i jobesimtarëve në momentin e vdekjes**

Gjatë gjithë jetës së tyre, njerëzit përkujtohen shumë herë për ekzistencën e Xhennetit dhe të Zjarrit dhe se duhet të përgatiten për jetën e përtejme. Megjithatë, jobesimtarët bëhen të shurdhër ndaj këtyre paralajmërimeve. Pasi përballen me vdekjen, një nga burimet kryesore të pendimit të tyre është fakti se ata kanë çuar veten e tyre drejt shkatërrimit. Askush nuk i detyroi ata, ata, me vullnetin e tyre, e zgjodhën këtë fund të keq për veten e tyre. Që nga momenti i vdekjes jobesimtarët fillojnë të vuajnë nga pikëllimi. Frika e tmerrshme që ndjejnë në kohën e vdekjes është pikëllimi fillestar i kësaj vuajtje, të cilën All-llahu e sqaron në Kur'an si vijon:

**...dhe këmbët do të ngrijnë. Atë ditë, ai do të sillet te Zoti yt. Ai as nuk besoi dhe as nuk u fal, por e mohoi të vërtetën dhe ia ktheu kurrizin, e pastaj shkoi te njerëzit e vet, duke u krenuar. Mjerë për ty! Mjerë për ty! Sërisht: Mjerë për ty! Mjerë për ty! (Sure Kijame: 29-35)**

Megjithatë, njeriu duhet të mbaj në mend se vetëm jobesimtarët vuajnë nga kjo frikë. Besimtarët e kalojnë gjithë jetën e tyre duke punuar për të fituar kënaqësinë dhe dashurinë e



All-llahut. Për këtë arsye, ata janë plot shpresë. Jobsimtarët, në anën tjetër, përjetojnë një pendim të madh e të vonuar kur vdekja i mposht ata. Megjithatë, ky pendim në asnjë mënyrë nuk i mban ata të sigurt nga dënimi, sepse është shumë vonë. Në Kur'an, thuhet se në momentin e vdekjes, shpirtat e jobsimtarëve merren duke përjetuar vuajtje dhe vështirësi të madhe.

**...Ah sikur t'i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart (duke thënë): "Dorëzoni shpirtat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për All-llahun dhe që keni shpërfillur shpalljet e Tij". (Sure En'am: 93)**

**E çfarë do të bëjnë ata, kur engjëjt do t'ua marrin shpirtin, duke i rrahur në fytyrat dhe shpinat e tyre?! (Sure Muhammed: 27)**

Sigurisht se nuk ka gjasa për të kuptuar plotësisht atë që përjetojnë mosbesimtarët në kohën e vdekjes. Mirëpo, All-llahu e përshkruan këtë gjendje në mënyrë që njeriu të mund të meditojë dhe t'i shmanget takimit të një fundi të tillë. Engjëjt e vdekjes, siç sugjerojnë vargjet, do t'i marrin shpirtat e jobsimtarëve, ndërsa i godasin ata në fytyrat dhe shpinat e tyre. Që nga ai moment, jobsimtarët do të vuajnë dhimbje fizike të shoqëruar me një pendim të thellë pasi që e dinë se nuk kanë mundësi të kthehen prapa.

Në momentin e vdekjes, njeriu është plotësisht i vetëdijshëm për atë që i ndodhë atij. Ky është fillimi i jetës së tij të

përjetshme. Vdekja është vetëm një fazë kalimtare, ajo është në të vërtetë largimi i shpirtit nga mishi.

Për shkak të dënimit që ata vuajnë në kohën e vdekjes, jobesimtarët kuptojnë se do t'i nënshtrohen një dënimi të madh që do të zgjasë përjetësisht-përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe. Ata që kanë jetuar gjithë jetën e tyre të larguar nga feja e All-llahut fillojnë të luten në mënyrë të singertë për faljen e All-llahut dhe për shpëtim. Ata luten që të kthehen përsëri në dynja, për të bërë vepra të mira dhe për të kompensuar atë që kanë humbur. Por dëshirat e tyre nuk janë të pranueshme, sepse atyre u ishte "dhënë një jetë mjaft e gjatë që ata të merrnin mësim", siç pohon All-llahu në këtë ajet. Atyre u ishte dhënë lajmi i gëzuar për kopshtet e Xhennetit dhe ishin paralajmëruar gjithashtu për Zjarrin e Xhehennemit, por ata me kokëfortësi ishin larguar nga gjithë këto të vërteta. All-llahu shpall në Kur'an se ata përsëri do të priren drejt mohimit me dhënien e një mundësie tjetër:

**Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!" Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë... (Sure Mu'minun: 99-100)**

Jobesimtarët me vetëdije nuk iu përlënë në sexhde All-llahut, nuk i përmbushën urdhrat e Tij dhe as nuk iu bindën parimeve të larta morale. All-llahu thotë në Kur'an se në kohën e vdekjes, ata nuk do të jenë në gjendje madje edhe

vetëm të përulen në sexhde:

**Ditën (e Kiametit), kur të zbulohen shumë ngjarje të frikshme, ata do të thirren që të përulen në sexhde, por nuk do të munden! Të ulura do të jenë shikimet e tyre dhe do t'i mbulojë poshtërimi, sepse kanë qenë të ftuar të përuleshin në sexhde, sa qenë shëndoshë (dhe nuk kanë pranuar). (Sure Kalem: 42-43)**

Ekziston edhe një çështje tjetër që e bën edhe më të madh pendimin e njerëzve të cilët, në momentin e vdekjes, e kuptojnë se premtimet e All-llahut janë të gjitha të vërteta. Besimtarët, të cilëve jobesimtarët nuk iu besuan dhe nuk i morën me seriozitet në dynja dhe madje edhe u tallën me ta, nuk e përjetojnë aspak pikëllimin që e përjetojnë jobesimtarët në atë ditë. Ata shpërblehen përjetësisht me shpërblimet më të mira, sepse ata e jetuan gjithë jetën e tyre në mënyrë të sinqertë për të arritur kënaqësinë e All-llahut. Ndryshe nga jobesimtarët, shpirtat e tyre mirren "me butësi", pa asnjë dhimbje. (Sure Naziat: 2) Siç e përshkruan All-llahu në këtë ajet, engjëjt i përshëndesin besimtarët dhe u japin lajmin e gëzuar të Xhennetit.

**...të cilëve engjëjt ua marrin shpirtat, duke qenë të pastër. U thonë atyre: "Shpëtimi qoftë mbi ju! Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!" (Sure Nahl: 32)**

Kjo është një vuajtje tjetër mendore për jobesimtarët. Atyre u janë ofruar po ato mundësi të njëjta që iu ofruan edhe besimtarëve në këtë botë. Megjithatë, ata me dashje i

ndërruan të mirat e përjetshme të Xhennetit për të mirat kalimtare të kësaj bote. Edhe pse u përkujtuan se bota është vetëm një vend sprove për njeriun dhe se banesa e vërtetë është Ahireti, ata u shtinë si të padijshëm për këtë. Prandaj ata nuk u angazhuan në vepra të mira për të arritur Xhennetin. Megjithatë, të jetuarit sipas moralit të Kur'anit dhe të qenit një besimtar i sinqertë është e mundur për çdonjërin vetëm nëse njeriu bëhet i përkushtuar për këtë qëllim. Të menduarit mbi të gjitha këto e bën edhe më të madh pendimin e jobesimtarëve.

Në një ajet All-llahu thotë:

**A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t'i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata! (Sure Xhathije: 21)**

Me fjalë të tjera, secili njeri do të shpërblehet ashtu siç e meriton, të mirët me lajm të gëzuar ndërsa të këqinjët me dënim të xhindosur.

Për më tepër frika e njohurisë se Xhehennemi është i përgatitur për ta do ta forcojë edhe më shumë pendimin që ndëjnë jobesimtarët. Deri atëherë ata kanë përjetuar vetëm vuarjetjen e largimit të shpirtrave të tyre. Kjo vuajtje megjithatë i bën ata të vetëdijshëm për dënimin e tyre të afërt.

Ky pendim i jobesimtarëve që fillon me vdekjen do të zgjasë për aq kohë sa dëshiron All-llahu. Ata do të mbeten në këtë dënim të përjetshëm në çdo moment, orë dhe ditë që kalon dhe nuk do të kenë shpëtim nga pendimi.

Megjithatë, është në dorën e njeriut të mos vuajë një pendim kaq të madh. Të presësh të takosh vdekjen nuk është medoemos mënyra për ta kuptuar realitetin e vdekjes dhe përtej saj. Për besimtarët, mjafton premtimi i All-llahut. Pas vdekjes, drejtësia e All-llahut mbizotëron pa dyshim; jobesimtarët ndëshkohen me zjarr dhe besimtarët shpërblehen me kopshtet e Xhennetit.

Pra, gjëja më e zgjuar që duhet ta bëjë një person që nuk ka takuar ende vdekjen do të ishte që të kërkojë strehim tek All-llahu dhe të shpresojë në faljen e Tij. Përveç kësaj, njeriu duhet të shqyrtojë me vëmendje Kur'anin, udhërrëfyesin e vetëm për në rrugën e drejtë për njerëzimin, dhe sunnetin e Profetit (savs) për të formuar një kuptim të plotë dhe për të jetuar sipas asaj që urdhërohet. Në vend të shmangies nga të menduarit për vdekjen, njeriu do të përfitojë nga të medituarit mbi realitetin dhe afërsinë e saj dhe duke vepruar në pajtim me këtë.

Ai që i kthehet All-llahut fiton pëlqimin e All-llahut si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër dhe hyn në Xhennet, i kënaqur me Zotin tonë dhe Zoti ynë, i kënaqur me të. All-llahu u jep besimtarëve lajmin e gëzuar për këtë në Kur'an:

**O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim! (Sure Fexhr: 27-30)**

Mënyra për t'iu shmangur pendimit dhe për të fituar lumturinë e përjetshme është të reflektojmë mbi vdekjen dhe Ahiretin dhe të jetojmë në rrugën e All-llahut, Krijuesit të njeriut.



# *Pendimi që ndien njeriu në Ditën e Gjykimit*



*Kur do t'i fryhet Surti, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do All-llahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin. Dhe Toka do të shëndritet me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (t veprave). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmtarët e ata do të gjykohen me drejtësi, e nuk do t'u bëhet asnjë padrejtësi. Secilit do t'i jepet shpërblimi për atë që ka bërë, sepse Ai e di më së miri se çfarë kanë punuar. (Sure Zumer: 68-70)*

Të gjithë ata që kanë jetuar ndonjëherë në tokë ringjallen në Ditën e Gjykimit. Momenti i ringjalljes është një moment hutues për jobesimtarët. All-llahu rrëfen për bisedat plot frikë dhe huti në mesin e jobesimtarëve në momentin e ringjalljes në Kur'an si vijon:

**Duke thënë: "Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?" (Do t'u thuhet): "Ja, kjo është ajo që ka premtu-**

**ar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit kanë thënë të vërtetën!” (Surah Ja Sin: 52)**

**Dhe të afrohet premtimi i vërtetë (Kiameti), atëherë sytë e atyre që nuk kanë besuar, do të zgurdullohen, (e thonë): “Mjerë për ne! Ne kemi qenë të pavëmendshëm ndaj kësaj dhe e kemi ngarkuar veten me gjynahe”. (Sure Enbija’: 97)**

Fraza "Të mjerët ne" është një shprehje e panikut të madh, e frikës dhe pendimit të jobesimtarëve. Në momentin kur ringjallen, ata e kuptojnë se ata që i paralajmëruan ata për Ahiretin ishin të drejtë dhe të sinqertë. Ata tani janë të vetëdijshëm, në dëmin e tyre, se paralajmërimet e tjera do të dalin në shesh njëra pas tjetrës. Atëherë, pa asnjë mundësi për të shpëtuar, ata do të tërhiqen zvarrë drejt kësaj vuajtje, të cilën ata kurrë më parë nuk e konsideruan si të vërtetë.

Pas ringjalljes prej të vdekurve, jobesimtarët do të sillen për të dalë para All-llahut. Atëherë ata do të thirren të japin përgjegjësi për atë që vepruan në dynja dhe gjykimi do të bëhet në përputhje me rrethanat. Për këtë qëllim, ata sillen në Praninë e All-llahut me të gjithë ata njerëz të tjerë arrogantë që i tejkaluan kufijtë e përcaktuar nga All-llahu.

**Atë Ditë do të fryhet në Sur dhe ju do të vini grupe-grupe. (Sure Nebe: 18)**

Në ditën e gjykimit, jobesimtarët do të kuptojnë se asnjë veprim tjetër nuk është më i rëndësishëm se të fituarit e kënaqësisë së All-llahut dhe shmangjes së zemërimit të Tij. Kjo theksohet gjithashtu edhe në një hadith të Profetit (savs)

në të cilin ai dha shembullin e një jobesimtari që merret në pyetje në ditën e gjykimit:

Një jobesimtar do të sillet në Ditën e Ringjalljes dhe do të pyetet. "Ta marrim se ke pasur aq shumë ari sa ta mbushësh tokën me të, a do ta jepje atë për ta liruar veten?" Ai do të përgjigjet: "Po". Atëherë atij do t'i thuhet: "Nga ti është kërkuar diç më e lehtë se kjo [të mos i bashkosh askënd All-llahut në adhurim (dmth. të pranosh Islamin, por ti nuk pranove)]" (Buhariu)

Dështimi i tyre për ta kuptuar këtë fakt në dynja, ku shenjat e fuqisë dhe të ekzistencës së All-llahut ishin të qarta, e shton pendimin e tyre. Atë ditë, ata do të shohin qartë se e kanë humbur këtë mundësi. Pendimi i tyre është i dukshëm nga mënyra se si flasin:

**Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: "Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kur'ani) që më kishte ardhur!" Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës. (Sure Furkan: 27-29)**

Në Ditën e Gjykimit, mosbesimtarët do të jenë aq të zënë me telashet e veta sa që bëhen të shurdhër ndaj thirrjeve të fëmijëve, bashkëshortve, nënave dhe baballarëve të tyre. Në Kur'an, kjo përshkruhet si më poshtë:

**Por, kur të vijë Ushtima, atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq**

**shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë. (Sure Abasa: 33-37)**

Koncepti i familjes humb rëndësinë e vet. Që nga ai moment, e vetmja gjë që ka rëndësi është që të shpëtojnë nga dënimi i All-llahut. Kjo është aq e rëndësishme sa që, për të shpëtuar nga kjo gjendje, jobesimtarët ofrojnë për sakrificë madje edhe fëmijët, bashkëshortët, vëllezërit e tyre, etj.

**Atë Ditë qielli do të bëhet si llumi i vajit e malet do të bëhen si lesh i shprishur, shoku s'do të pyesë për të shokun, edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin. Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifikonte me gjithë qejf fëmijët e vet, edhe gruan, edhe vëllanë e vet, edhe farefisën, që i gjendej pranë (në jetën e Tokës), si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte. (Sure Me'arixh: 8-14)**

Sigurisht, këto përpjekje të jobesimtarëve nuk sjellin asnjë rezultat. Qëllimi kryesor i jobesimtarëve në jetën e kësaj bote ishte që të grumbullonin pasuri, të bënin karrierë, apo të kishin djem. Ata e kaluan gjithë jetën e tyre për arritjen e këtyre synimeve. Megjithatë, në Ditën e Gjykimit, ata e kuptojnë se të gjitha këto koncepte nuk kanë asnjë vlerë. Dita e Gjykimit është koha kur jobesimtarët do të dëshirojnë të zhduken. Megjithatë, për besimtarët kjo është koha që ata e kishin pritur me padurim dhe me gëzim. All-llahu i përshkruan këto momente në ajetet e Tij, si më poshtë:

**Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhuro-sura, që do t'i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët. (Sure 'Abese: 38-42)**

Në Ditën e dhënies së llogarisë, gjërat më të çmuara që posedon njeriu janë veprat e mira që janë bërë vetëm për të fituar kënaqësinë e All-llahut. Megjithatë, jobesimtarët kurrë nuk janë përpjekur për këtë thesar, i cili do t'iu sillte atyre shpëtimin e përjetshëm. Ata nuk kanë as edhe një vepër të vetme të mirë apo mirësi për ta paraqitur para All-llahut në atë ditë. Duke mos pasur besim në All-llahun, të gjitha përpjekjet e tyre të drejta do të fshihen. All-llahu e pohon këtë fakt si më poshtë:

**Thuj: "A doni t'ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?" Këta janë ata, që nuk kanë besuar në shpalljet e Zotit të tyre dhe në takimin me Të. Punët e tyre do të fshihen, andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta (për veprat e tyre), në Ditën e Kiametit. (Sure Kehf: 103-105)**

Ata që e mohuan fenë (dinin) dhe kishin dyshime në lidhje me ekzistencën e Ditës së Gjykimit, nuk ndjenë nevojë për t'u përgatitur për këtë ditë që po afrohet. Një jetë të tërë, ata u preokupuan me grumbullimin e pasurisë dhe duke i ndjekur dëshirat e tyre të kota. Tani ata ballafaqohen me një pendim nga i cili nuk do të lirohen kurrë. All-llahu e thotë



këtë në Kur'an në këtë mënyrë:

**Dhe do të thonë: “Mjerë për ne, kjo është Dita e Gjykimit!” Po, kjo është Dita e Gjykimit, të cilën ju e keni përgënjeshtuar! (Sure Saffat: 20-21)**

Për më tepër, jobesimtarët do t'i gjejnë të gjitha veprat e pandershme, të pakëndshme dhe të këqija që i kanë kryer në dynja të zbuluara në Praninë e All-llahut. Ata do të dëshmojnë personalisht për mëkatet që i kanë bërë. All-llahu e përshkruan këtë në Kur'an si vijon:

**...Ata do të sillen të radhitur para Zotit tënd (e do t'u thuhet): “Tashmë Na erdhët, ashtu siç ju krijuam herën e parë, ndonëse ju (o jobesimtarë) pretendonit se nuk do t'ju caktonim një takim (ringjalljen)”. Dhe Libri (i veprave të tyre) do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: “Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë”. Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt. (Sure Kehf: 48-49)**

**Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë. (Sure Zelzele: 6-8)**

Siç rrëfen All-llahu në Kur'an, atëherë vjen koha për

jobesimtarët për t'i parë librat e veprave të tyre.

Besimtarët i marrin librat e veprave të tyre nga ana e tyre e djathtë, ndërsa jobesimtarët nga ana e tyre e majtë. Që nga momenti kur engjëjt e vdekjes morën shpirtat e tyre, jobesimtarët iu nënshtruan një vuajtje të pafund. Momenti kur ata i marrin librat e veprave të tyre është një tjetër vuajtje. Ata largojnë shikimin nga mëkatet e bëra dhe dëshirojnë të zhduken. All-llahu e përshkruan këtë në vargjet në vazhdim:

**Por ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: "Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!" (Sure Hakka: 25-29)**

**...Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: "Ah, sikur të isha pluhur!" (Sure Nebe: 40)**

**Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet, sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari). Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij! (Sure Inshikak: 10-15)**

Duke qenë dëshmitarë të këtyre skenave, jobesimtarët e kuptojnë mundësinë që humbën në dynja dhe ndjejnë një pendim shumë të ashpër. Pendimi i tyre bëhet edhe më i madh kur ata shohin dhe vëzhgojnë jetën e lumtur të besimtarëve në Xhennet. Sepse më parë, ata u ftuan në të vërtetën nga besimtarët, por refuzuan me mendjemadhësi dhe u bën të shurdhër ndaj tyre.

Por tani vendosen "peshore të sakta" (Sure Enbija': 47). Njerëzit çohen në Xhehennem apo Xhennet, bazuar në librat e veprave të tyre. Në Ditën e Gjykimit, jobesimtarët e kuptojnë se për ku janë drejtuar. Me këtë, ata i pushton frika:

**Atë Ditë ti do t'i shohësh keqbërësit se si tmerrohen për atë që kanë fituar, ndërkohë që ndëshkimi Ynë do t'i godasë me siguri. (Sure Shura: 22)**

Drejtesia e All-llahut mbizotëron dhe përfshin shpërblimin dhe dënimin më të drejtë:

**Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje. (Sure Enbija': 47)**

Ky proces është i lehtë për besimtarët. Mirëpo, ai dëshmohet të jetë i vështirë dhe shumë i dhimbshëm për jobesimtarët. Ata do të japin përgjegjësi për çdo mirësi që All-llahu u dha atyre në dynja. Ata do të japin llogari për çdo moment të jetës së tyre: për dështimin e tyre për t'iu bindur urdhërave të All-llahut, qëndrimet e tyre mosmirënjohëse, mendimet dhe fyerjet e tyre të brendshme rebele, paralajmërimet që ata i shpërfillën. Megjithatë justifikimet e pasinqerta që ata kishin zakon t'i shprehnin në dynja më nuk janë të pranueshme. All-llahu e përshkruan gjendjen me të cilën përballen jobesimtarët në atë ditë në vargjet më poshtë:

**Mjerë mohuesit në atë ditë! Kjo është një ditë, kur ata nuk do të mund të flasin dhe nuk do t'u jepet leje për t'u shfaqësuar. Mjerë mohuesit në atë ditë! Kjo është Dita e Ndarjes**

**vendimtare, në të cilën do të tuboheni ju dhe popujt e lashtë, prandaj, nëse zotëroni ndonjë dinakëri, përdoreni kundër Meje! Mjerë mohuesit në atë ditë! (Sure Murselat: 34-40)**

Ata jobesimtarë pa vepra të mira për t'i paraqitur para Allahut **"do të dijnë se çka kanë bërë gati"** (Sure Tekvir:- 14) për veten. All-llahu e përshkruan këtë vend të vuajtjes "si një" humnerë të pafund ", në Kur'an:

**Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet). E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehennemit). Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehennemit)? Ajo është një Zjarr i vrullshëm. (Sure Kari'a: 6-11)**

Këto janë të rëndësishme për të kuptuar thellësinë e pendimit që do ta përjetojnë jobesimtarët në Ditën e Gjykimit. Është tepër vonë që njeriu të ndjejë pendim në Ditën e Gjykimit. Nëse njeriu e kupton plotësisht se çfarë po i thuhet këtu dhe nuk humb aspak kohë për t'u angazhuar në vepra të mira, atëherë ai mund të shpresojë për një "bilanc të rëndë (të veprave të mira)." Vetëm një përpjekje e tillë do ta shpëtojë njeriun nga pendimi i madh.

# *Pendimi që ndjenë njeriu në Xhehennem*



*Kur ai t'i vërë re prej së largu, ata do t'i ta dëgjojnë vëltnin dhe  
rënktnin. (Sure Furkan: 12)*

## **Pendimi që ndiejnë jobesimtarët kur shohin Xhehennemin**

Në Ditën e Gjykimit, kur të kenë dhënë llogari, njerëzit do të tubohen dhe do të shtyhen në Xhehennem në "grupe." Në këtë turmë do të jenë të gjithë ata që e mohuan fenë dhe ekzistencën e All-llahut gjatë gjithë historisë dhe ata që ishin kryelartë dhe ua kthyen shpinën shenjave të All-llahut. Në mesin e tyre do të jenë edhe ata që gëzonin pasuri dhe famë. Megjithatë, për zhgënjimin e tyre, ato gjëra të cilave ata u kishin kushtuar rëndësi në dynja nuk do t'i shpëtojnë ata nga dënimi i përjetshëm. All-llahu na njofton në Kur'an se të gjithë ata që nuk besuan do të tërhiqen zvarrë të turpëruar në Xhehennem. Para dyerve të Xhehennemit, rojet e tyre do t'i shtyjnë ata të pranojnë mëkatet e tyre për herë të fundit dhe



do t'i fusin në të. Pas kësaj, dyert do të mbyllen pas tyre përjetësisht. All-llahu e përshkruan në Kur'an mënyrën në të cilën jobesimtarët shtyhen në Xhehennem si vijon:

**Jobesimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehennem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij dhe rojtarët do t'u thonë atyre: "A nuk ju kanë ardhur të dërguar midis jush, të cilët ju lexonin shpalljen e Zotit tuaj e ju tërhiqnin vërejtjen për takimin e kësaj dite?!" Mohuesit do të thonë: "Po, është e vërtetë!" E kështu përmbushet fjala e All-llahut për dënimin e mohuesve. Atyre u thuhet: "Hyni në portat e Xhehennemit, ku do të qëndroni gjithmonë!" Sa vend i shëmtuar që është ai për mendjemëdhenjtë!**  
(Sure Zumer: 71-72)

**Ky dënim është për shkak se gëzoheshit në tokë, pa kurrfarë të drejte dhe ngaqë keni qenë të ndërkryer. Hyni në dyert e Xhehennemit për të qëndruar përherë në të! Sa i shëmtuar që është vendbanimi i mendjemëdhenjve! (Sure Gafir: 75-76)**

As edhe një person i vetëm nga mesi i kësaj turme nuk do të mund të dalë dhe të thotë se nuk ishte paralajmëruar për këtë ditë. Kjo për arsye se All-llahu, i Cili është i Drejti, kishte dërguar lajmëtarë tek çdo individ për ta përkujtuar atë për ekzistencën e Tij, Ditën e Gjykimit, Xhennetin dhe Xhehennemin. Prandaj, mosbesimtarët do të pranojnë se e meritonin dënimin në Xhehennem.

Ata mbetën arrogant edhe pse ishin paralajmëruar dhe

me vetëdije nuk pranuan t'i shërbejnë All-llahut, i Cili i krijojti ata. All-llahu e bën me dije njeriun në Kur'an se të tillët do të jenë të poshtëruar në Xhehennem:

**Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehennem të poshtëruar”! (Sure Gafir: 60)**

I Dërguari i All-llahut (savs) e ka theksuar të njëjtën gjë në një hadith:

...A t’ju njoftojë për banorët e Zjarrit? Në të do të jetë çdo njeri i vrazhdë, i dhunshëm, krenar dhe mendjemadh. (Buhariu)

Duke e konsideruar veten si të gjithë-fuqishëm në dynja, disa nga këta njerëz u rebeluan paturpësisht ndaj Zotit tonë. Ata menduan se fuqia do t’ju sigurojë shpëtim atyre. Kur u përkujtuan për vetinë el-Kahar (Nënshtuesi) të All-llahut, për ekzistencën e Xhehennemit dhe të Xhenetit, dhe ju ofrua udhëzim për në rrugën që e pëlqen All-llahu, ata u përgjigjën:

**“Pse nuk na dënon All-llahu për këtë që po flasim?” Xhehennemi është një dënim i mjaftueshëm për ata. Në flakët e tij do të digjen. Eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai! (Sure Muxhadile: 8)**

Si përgjigje ndaj rebelimit të tyre, ata do të futen brenda dyerve të Xhehennemit dhe kurrë më nuk do të lejohen që të dalin prej aty përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe. Që nga momenti që e shohin Zjarrin, ata do të ndjejnë një

pendim të padurueshëm për gabimet e tyre. All-llahu shpall në Kur'an se ky është momenti kur ata e kuptojnë qartë se nuk ka asnjë mënyrë për të dalë nga Xhehennemi:

**Të ligjtë do të shohin zjarrin dhe do të binden, se me të vërtetë, do të bien në të dhe nuk do të gjejnë largim prej atij. (Sure Kehf: 53)**

Të kuptuarit do të jetë shumë i mprehtë në Xhehennem; gjithçka për çka jobesimtarët u shtirën si të paditur në dynja, atëherë do të duket shumë e qartë. Ata do të kuptojnë se ata e jetuan gjithë jetën e tyre për qëllime të kota dhe në fund do ta kuptojnë se, në këmbim të përfitimeve të vogla dhe të përkohshme, ata do të duhet të jetojnë në vuajtje në jetën e përtejme. Pak dekada që ata i kishin në botë u dukeshin një kohë e gjatë dhe ndërkohë ata nuk menduan kurrë për Ahiretin. Ata e parapëlqyen këtë botë ku njeriu e ndjen veten të pakënaqur në mënyrë të parikuperueshme më shumë se një jetë të përsosur dhe të lumtur ku njeriu nuk është i prekshëm nga dobësitë fizike siç janë uria dhe rraskapitja. Posa të hyjnë nëpër portat e Xhehennemit ata e kuptojnë se nuk kanë shpëtim. Kështu, si një rrugëdalje e fundit për t'iu shmangur dënimit, ata kërkojnë shpëtim duke ofruar një shpërblese: një shpërblese me gjithçka që kishin në këtë botë. Këto përpjekje të kota janë përshkruar si më poshtë:

**...Ndërsa ata që nuk i përgjigjen Atij - sikur të ishte e tyre gjithçka që gjendet në Tokë, madje edhe një herë aq, ata do ta sakrifikonin atë (për të shpëtuar). Njerëzve të tillë u është përgatitur llogari e rëndë dhe strehimi i**

**tyre është Xhehennemi. Eh, sa shtrat i shëmtuar që është ai! (Sure Ra'd: 18)**

Megjithatë, këto përpjekje të fundit që shfaqen me përballjen me të vërtetën e hyrjes në Xhehennem do të jenë të kota. All-llahu na bën me dije se këto përpjekje nuk sjellin dobi:

**Sot nuk pranohet prej jush kurrfarë shpërblese e as prej atyre që nuk kanë besuar: zjarri është vendbanimi juaj, ai është për ju; eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai!" (Sure Hadid: 15)**

Natyrisht se ekziston një arsye domethënëse pse këto përpjekje nuk sjellin asnjë rezultat. All-llahu i paralajmëroi ata për Xhehennemin, kur ata ishin ende në dynja. Çdo gjë u bë e qartë për ta; se askush nuk do të jetë në gjendje ta ndihmojë një tjetër dhe se askush nuk do të jetë në gjendje të ofrojë ndonjë shpërblesë. Ata u përkujtuan edhe se nuk do të pranohet asnjë shpërblesë. Një ajet të cilin All-llahu e shpalli për t'i paralajmëruar njerëzit në lidhje me këtë fakt është si vijon:

**Frikësojuni Ditës kur askush nuk do të mund të bëjë asgjë për askënd dhe, kur prej askujt nuk do të pranohet as ndërmjetësim, as shpërblesë e as që do të ndihmoheni. (Sure Bekare: 48)**

Megjithatë, përkundër të gjitha paralajmërimeve, ata këmbëngulën në mohimin e tyre dhe me vetëdije përgatitën një fund të tillë për veten e tyre. Në atë ditë, ata do të pranojnë një të vërtetë domethënëse: se ata e merituan

Xhehennemin për shkak të veprave të tyre.

Ky pendim, përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe, do të jetë një mundim i madh nga i cili nuk do të gjejnë shpëtim përjetësisht. Kjo për arsye se ata janë ndeshur me një fakt të rëndësishëm: po të kishin qenë të përkushtuar për të fituar pëlqimin e All-llahut në vend se të përpiqen për qëllime të kota, ata nuk do të ishin në hyrjen e Xhehennemit, por në Xhennet. Për shkak të dështimit të tyre për të ndjekur rrugën e drejtë, ata vuajnë një humbje të tmerrshme.

Siç thotë All-llahu në ajetin e njëzetë të Sures el-Beled, **"mbi ta do të jetë zjarri i mbyllur."** Pasi që ata të hyjnë nëpër portat e Xhehennemit, ata do të mbyllen brenda. Pas këtyre portave ekziston dënimi i Xhehennemit me fund të pacaktuar, të cilin ata do ta vuajnë për aq kohë sa dëshiron All-llahu. Për jobesimtarët, nuk ka asnjë mundësi për të shpëtuar nga kjo vuajtje. All-llahu e quan këtë zjarr "Shkatërrimtar." Kështu shkruan në vargjet vijuese të Sures el-Humeze:

**E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i All-llahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut. Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë, në shtylla të gjata flakëruese. (Sure Humeze: 5-9)**

Dënimi me të cilin përballen jobesimtarët në Xhehennem

Para se të vazhdojmë me pendimin me të cilin do të përballen jobesimtarët në Ahiret, do të jetë e dobishme ta përshkruajmë vuajtjen në Xhehennem. Pa qenë të vetëdijshëm për format e vuajtjes në Xhehennem, njeriu mund të dështojë

jë në të kuptuarit e dimensioneve të pendimit atje.

Siç u përmend më herët, pendimi i jobesimtarëve fillon që nga momenti kur ata e shohin Xhehennemin dhe pastaj vazhdon përjetësisht. Bisedat në mesin e këtyre njerëzve me ardhjen e tyre në Xhehennem janë si më poshtë:

**Kurse për ata, që e mohojnë Zotin e tyre, dënimi është Xhehennemi; eh, sa i shëmtuar është ai vendbanim! Kur të hidhen aty, do të dëgjojnë ulërimën e tij, ndërkohë që ai vlon gati për të shpërthyer me furi. Sa herë që aty të hidhet ndonjë grup, rojtarët e tij do t'i pyesin ata: "A nuk ju erdhi ndonjë paralajmërues?" "Po - do të përgjigjen ata - na kanë ardhur vërtet paralajmërues, por ne i quajtëm ata gënjeshtarë dhe thamë: "All-llahu nuk ka shpallur asgjë; ju jeni në një humbje të madhe"! Ata do të thonë: "Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!" Kështu, ata do ta pranojnë gjynahun e tyre. Larg qofshin prej mëshirës së Zotit banorët e Zjarrit Flakërues! (Sure Mulk: 6-11)**

Siç ka shpallur All-llahu në këto vargje, kur ata të hidhen në Xhehennem, do të dëgjojnë një zhurmë të tmerrshme. All-llahu e përshkruan këtë zhurmë në ajetin e shtatë të Sures el-Mulk si: **"duke ulëritur, ndërkohë që ai vlon."** Ky zë i tmerrshëm shkakton një vuajtje dhe frikë të tmerrshme tek jobesimtarët. Në një ajet tjetër, All-llahu e përshkruan Zjarrin e Xhehennemit si një zjarr që gati shpërthen me furi (Sure el-Mulk: 8). Refuzuesit kur e përjetojnë këtë ngjarje të



tmerrshme do të ndjehen të dëshpëruar, sepse do të kuptojnë ndëshkimin me të cilin do të përballen. Dhe siç shpalli më lart Zoti ynë, ata do të flasin për pendimin e tyre për shkak të dështimit të tyre për të pasur një kuptim më të mirë për çdo gjë ndërsa ishin ende në dynja.

Ata do të përjetojnë një vuajtje të tillë të pamëshirshme, sepse do të kuptojnë se dënimi me të cilin do të ballafaqohen do të jetë jashtëzakonisht i tmerrshëm dhe i dhimbshëm. Në vargjet vijuese, theksohet se Xhehennemi është vendi më i keq për të qëndruar.

**...Eh, sa strehim i keq është ai! (Sure Al 'Imran: 162)**

**...Sa vendbanim i keq! (Sure Nisa': 115)**

**Vendbanimi i tyre është zjarri e sa vendstrehim i shëmtuar është ky për keqbërësit! (Sure Al 'Imran: 151)**

**Ata do të digjen në Xhehennem. Eh, sa vendbanim i tmerrshëm është ai! (Sure Ibrahim: 29)**

Xhehennemi është përshkruar në një mënyrë të ngjashme në hadithet e Pejgamberit (savs):

*Në mesin e banorëve të Zjarrit ka prej atyre të cilët do të jenë të zhytur në zjarr gjer në nyjet e këmbëve të tyre, disa gjer tek gjunjët e tyre, disa gjer në bel dhe disa gjer në fyt. (Muslimi)*

Banorët e Xhehennemit do të hidhen poshtë në këtë vend të shëmtuar në grupe. Në një ajet All-llahu e shpall këtë në këtë mënyrë: "**Ata do të hidhen në zjarr bashkë me mohuesit**" (Sure Shu'ara: 94) Nga ky ajet, kuptohet që të gjithë jobesimtarët duke përfshirë edhe ata që ishin kryelartë, që

kishin pasuri dhe ishin të nderuar, do të hidhen në zjarr si masa të pavlefshme. Si përgjigje ndaj arrogancës së tyre në dynja, ata do të jenë të poshtëruar dhe të përbuzur në atë ditë.

Në Xhehennem, ata kurrë nuk do të jenë të nderuar dhe kurrë nuk do të jenë të mëshiruar. Si lëndë djegëse e Xhehennemit, ata do të jetojnë në dhimbje dhe mjerim për gjithë përjetësinë. All-llahu zbulon këtë fakt në ajetet në vazhdim:

**Me të vërtetë, ju (idhujtarë) dhe idhujt që i adhuroni në vend të All-llahut, do të jeni lëndë djegëse për Xhehennemin. Ju do të vini në të. (Sure Enbija': 98)**

**...Ata do të jenë lëndë djegëse e zjarrit. (Sure Al 'Imran: 10)**

All-llahu na njofton në Kur'an për format e ndryshme të ndëshkimit në Xhehennem. Shumica e njerëzve do të banojnë aty, siç thuhet në ajet, "për kohë të gjatë." Me fjalë të tjera, ata do të mundohen për aq kohë sa dëshiron All-llahu. Ne mund t'i përshkruajmë disa nga këto ndëshkime si vijon:

Në ajetin e trembëdhjetë të Sures el-Furkan, All-llahu rrëfen se mosbesimtarët do të hidhen "në një vend të ngushtë në Xhehennem të lidhur së bashku në pranga." Lënia e njeriut të mbyllur në një hapësirë të ngushtë madje edhe për disa minuta e bën atë të tendoset. Madje edhe mendimi i të qenit i rrethuar nga të katër anët me mure është shpesh një mendim i padurueshëm. Dënimi i Xhehennemit është, megjithatë, i pakraha-

sueshëm me atë të dynjasë. Të mbyllur në atë hapësirë të ngushtë, ata do t'i nënshtrohen edhe zjarrit. Për më tepër, të lidhur së bashku në zinxhirë, ata nuk do të jenë në gjendje të lëvizin, e lëre më të ikin nga zjarri. Madje edhe të përfytyrohet një skenë e tillë është e dhimbshme.

Në një ajet tjetër, All-llahu na njofton se jobesimtarët do të mbeten në **"hije të një tymi të zi"** (Sure Uakí'a: 43). Në përgjithësi, fjala "hije" na sjell në mendje një freski. Megjithatë, ky nuk është rasti me Xhehennemin. Në Xhehennem, All-llahu na njofton se kjo hije nuk është as e ftohtë e as freskuese.

Një formë tjetër e dënimit në Xhehennem është pamundësia e vdekjes. Vdekja është një mënyrë shpëtimi. Për këtë arsye, All-llahu nuk do të lejojë që njerëzit e Xhehennemit të vdesin siç **pohon Ai në ajetin, "vdekja do t'u vijë atyre nga të gjitha anët, por nuk do të vdesin"** (Sure Ibrahim: 17). Ata do të përjetojnë çdo lloj lëndimi që, në kushte normale, do të rezultonte me vdekje. Përkundër kësaj, ata nuk do të vdesin, por në vend të kësaj do të vazhdojnë të vuajnë vuajtje edhe më të madhe për aq kohë sa dëshiron All-llahu në jetën e tyre të përjetshme.

Fakti që nuk do të ketë vdekje tjetër në botën tjetër është deklaruar edhe nga Profeti Muhammed (savs):

*Kur banorët e Xhennetit të kenë shkuar në Xhennet dhe të burgosurit e Zjarrit të kenë shkuar në Zjarr, do të thirret vdekja dhe do të vendoset në mes të Xhennetit dhe Zjarrit. Pastaj do të bëhet kjo shpallje: "Banorë të Xhennetit, nuk ka më vdekje! Të burgosur të Zjarrit, nuk ka më vdekje!" Kjo do të shtojë kënaqësinë e banorëve të Xhennetit dhe pikëllimin e të burgosurve të Zjarrit. (Muslimi)*

Në këtë botë, djegjet e rënda rezultojnë me vdekje për një kohë të shkurtër. Njeriu vështirë se mund t'i rezistojë zjarrit. Edhe në qoftë se njeriu nuk vdes, por vetëm pëson lëndime, nevojitet një kohë e gjatë për t'u shëruar plagët siç duhet. Por në Xhehennem, dënimi i zjarrit do të jetë i pakrahasueshëm me zjarrin që ne njohim në këtë botë. Në Xhehennem, sapo t'u digjen lëkurat, ato u ndërrohen me lëkura të tjera, për të shijuar dënimin më shumë. (Surja Nisa: 56) Thënë shkurt, në Xhehennem, njeriu do të vuajë një dhimbje të pafund të shkaktuar nga zjarri për aq kohë sa dëshiron All-llahu.

All-llahu përshkruan një formë tjetër të vuajtjes të shkaktuar nga zjarri në vargun e trembëdhjetë të Sures edh-Dharijat ku Ai thotë se banorët e Zjarrit do të mundohen nga Zjarri. Është pothuajse e pamundur për të kuptuar dhimbjen që do ta shkaktonte një gjendje e tillë. Njeriu do të mund të përfytyronte dhimbjen e madhe që do të shkaktonte kjo vuajtje duke marrë parasysh dhimbjet e vogla që shkakton një djegje e zakonshme në këtë botë. Ndërsa të gjitha këto ndodhin, njeriu do të përjetojë gjithashtu si vijon:

**Mandej do të lidhen në zinxhirë... (Sure Hakka: 32)**

**Ata do të lidhen në zinxhirë. (Surat al-Insan: 4)**

**Ata do të rrihen me kamxhikë prej hekuri. (Sure Haxhxi: 21)**

**Me zjarrin e Xhehennemit do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre. (Sure Teube: 35)**

**Mbi kokat e tyre do të hidhet ujë i valuar, (Sure Haxhxi:**

19)

**Rrobat do t'i kenë prej katrani e zjarri do t'ua mbështjellë fytyrat, (Sure Ibrahim: 50)**

**Ata nuk do të gjejnë pije të ftohtë, freskuese. Në atë ditë vetëm ujët e vluar (Sure Sad: 57) dhe gjaku e qelbi (Sure Hakka: 36) do të jenë të disponueshme.**

Ushqimi i vetëm që kanë banorët e Zjarrit, nga ana tjetër, janë frytet me gjemba të hidhura dhe pema e zekumit. All-llahu na njofton se si pema e zekumit do të rezultojë të jetë vuajtje për jobsimtarët:

**Pema e Zekumit do të jetë ushqim i gjynahqarit. Si tunxh i shkrirë ajo do të vlojë në barkun e tij, ashtu si vlon uji i nxehtë. (Engjëjve do t'u thuhet): "Rrëmbejeni atë dhe çojeni në mes të zjarrit flakërues! Pastaj, për dënim, hidhni mbi kokën e tij ujë të valuar (duke i thënë): "Shijoje këtë, o njeri "i fuqishëm" dhe "fisnik"! Ja, ky është dënimin për të cilin ju dyshoni!" (Sure Duhan: 43-50)**

Nga përshkrimet në Kur'an, ne e dimë që ushqimi në Xhehennem do të ketë një efekt mbytës në njerëz. Ata do të përpiqen ta pijnë atë pije prej ujit të qelbëzuar përnjëherë, por pa dobi, ata kurrë nuk do të arrijnë ta gëlltitin atë. Qelbi, që është gjëja më e pështirë në këtë botë për nga pamja dhe era e tij, do të jetë gjithashtu një prej ushqimeve të njerëzve në Xhehennem. Kjo do t'iu shkaktojë dhimbje të madhe banorëve të Zjarrit, por, nga uria, ata nuk do të kenë zgjidhje tjetër, përveç se të hanë. Megjithatë, ajo që ata hanë nuk do të shuaj urinë e tyre. Ata

gjithashtu do të vuajnë dhimbjen e urisë përgjithmonë.

**Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese, të cilat as nuk do t'i mbajnë, as nuk do t'ua shuajnë urinë. (Sure Gashije: 6-7)**

All-llahu jep përshkrime të tjera në Kur'an lidhur me vuajtjen në Xhehennem:

**Ata do të gulçojnë në të (Sure Enbija': 100)**

**...që aty të mbeten përgjithmonë... (Sure Nebe': 23)**

**...Vuajtjet nuk do t'u lehtësohen dhe nuk do t'u jepet afat (pushim)... (Sure Al 'Imran: 88)**

**Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por s'do të mund të dalin dot. Ata i pret dënimi i përhershëm. (Sure Ma'ide: 37)**

Këto mundime do të shkaktojnë vuajtje dhe pendim të papërshkrueshëm tek jobesimtarët. Për të shpëtuar, ata do të luten shumë herë dhe madje do të japin pëlqimin që t'u merren shpirtat e tyre. All-llahu rrëfen bisedat e njerëzve në Xhehennem në Kur'an si vijon:

**Ata do të thërrasin: "O Malik! (Më mirë) Le të na vdesë Zoti yt!" Ndërsa Ai do të thotë: "Ju do të qëndroni përherë aty!" Tashmë, Ne ju kemi sjellë të Vërtetën, por shumica prej jush e urren të Vërtetën. (Sure Zuhruf: 77-78)**

Largimi nga feja (dini) dhe dështimi për të marrë mësim nga paralajmërimet do të shkojë në dëm të këtyre njerëzve, siç rrëfen All-llahu në Kur'an. Si përgjigje në këtë, All-llahu nuk do



t'iu përgjigjet thirrjeve të këtyre njerëzve dhe Ai do t'i mbajë ata në dënimin e tyre për aq kohë sa të dojë Ai.

Këto janë vetëm disa prej vuajtjeve që do t'u shkaktohen atyre që mohuan All-llahun dhe Ahiretin dhe që i shpërfillën paralajmërimet për ekzistencën e Xhehennemit dhe Xhennetit. Përveç kësaj, ekziston një vuajtje tjetër, vuajtje e cila do të mbetet gjithmonë me jobesimtarët. Kjo është ndjenja e pendimit që njeriu nuk do të jetë në gjendje ta harrojë as edhe për një moment. Kjo ndjenjë do të thellohet edhe më shumë me vuajtjen e shkakuar nga fakti se njeriu do të dërgohet në Xhehennem, në vendin më të tmerrshëm që njeriu mund ta shoh ndonjëherë. Siç është thënë më herët, çdo moment që jobesimtarët do të përjetojnë vuajtje, do t'i përkujtoj ata se, po të kishin ndjekur rrugën e drejtë, asnjë nga këto do t'iu ndodhte atyre. Nuk ka mënyrë për t'iu shmangur këtij pendimi.

### **Pendimi që do të ndjejnë jobesimtarët në Xhehennem**

Duke e përjetuar ashpërsinë e dënimit, mosbesimtarët do të jenë të mbërthyer nga pendimi pse nuk kishin besuar në All-llahun ndërsa ishin ende në dynja. Megjithatë, ky pendim nuk do ta ndryshojë gjendjen e tyre. Në dynja, atyre u ishin ofruar shumë mundësi, të cilat ata nuk arritën t'i shfrytëzojnë. Posa të arrijnë ta kuptojnë këtë të vërtetë, ata do të qajnë për çdonjërin dhe çdo gjë që atyre ua ka shkëputur mendjen nga All-llahu dhe Ahireti dhe që kanë ndikuar që ata të jepen pas gjërave të kësaj bote.

Në Kur'an, pendimi që ndjejnë jobesimtarët është plot zemërim, siç thotë All-llahu në ajetin e mëposhtëm:

**Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: "Ah, sikur t'i ishim bindur All-llahut dhe të Dërguarit!" Dhe do të thonë: "O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!" (Sure Ahzab: 66-68)**

**Dhe, kur të vijë te Ne, (jobesimtari) do t'i thotë (djallit që e kishte shok): "Ah, sikur të kishte qenë largësia midis meje dhe teje sa ajo mes lindjes e perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!" (Atyre do t'u thuhet): "Nuk do t'ju bëjë dobi (pendimi) juve sot, sepse ju u larguat nga e vërteta dhe humbët. Me të vërtetë, ju jeni pjesëtarë në dënim". (Sure Zuhruf: 38-39)**

Siç sugjerojnë këto vargje, ata shpresojnë të shpëtojnë veten e tyre duke i fajësuar ata që i larguan nga rruga e drejtë. Mirëpo, All-llahu i dhuroi çdonjërit një ndërgjegje në mënyrë që ai të udhëzohej në rrugën e drejtë. All-llahu gjithashtu e pajisi njeriun me vullnet për t'i zbatuar vendimet e tij përkatëse. Në këtë kuptim, njeriu është i pajisur me të dy alternativat, si edhe me njohjen e të drejtës dhe të gabuarës. Duke qenë kështu, zgjedhja e njeriut është krejtësisht e tij. Përveç kësaj, All-llahu e di nëse njeriu mban besimin apo mohimin thellë në zemrën e tij. Prandaj, ata njerëz që i çojnë njerëzit në Xhehennem, si edhe ata që iu bashkohen atyre do të dënohen me drejtësi. Atë ditë,

askush nuk do të mbajë përgjegjësi për gjynahet e tjetrit.

Ndërsa këta njerëz e joshën njëri-tjetrin në kryerjen e mëkatëve, mbase iu ka shkuar në mendje shumë herë se do të japin llogari për to në Ahiret, por sidoqoftë ata zgjodhën ta trajtojnë këtë çështje sikur ajo të ishte një çështje e parëndësishme. Ata inkurajuan njëri-tjetrin në mohim të All-llahut, duke thënë: "Unë do të mbajë përgjegjësi për atë që bën ti." Shejtani, nga ana tjetër, u bëri premtime joshëse atyre dhe i devijoi ata në rrugë të gabuar. Por All-llahu, me ajetin, "**... dhe ai do të vijë tek Ne krejtësisht i vetëm.**" (Sure Merjem: 80), na bën me dije se këto premtime nuk do të ndihmojnë aspak.

Atë ditë jobesimtarët do të shohin qartë se ata të gjithë janë të vetëm. Ata vet do ta kuptojnë një fakt të rëndësishëm: pos All-llahut, njeriu nuk ka as mik dhe as mbrojtës. Në Xhehennem, udhëheqësit e tyre dhe kushdo që ata i konsideruan si miq të tyre në dynja do t'i lënë ata krejtësisht vetëm. Gjithashtu, djalli, të cilin ata, duke e braktisur All-llahun, e morën si mbrojtës të tyre, do të jetë i pabesë ndaj tyre dhe do t'ju drejtohet atyre si në vazhdim:

**Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do të thotë: "Vërtet, All-llahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi. Unë tani e mohoj që më bëtë ortak me All-llahun (në adhurim)." Vërtet, keqberësit do të kenë një dënim të**

### **dhembshëm. (Sure Ibrahim: 22)**

Të kuptuarit e pabesisë së të gjithë atyre që ata i konsideruan si miq do të jetë edhe një tjetër burim pendimi për jobesimtarët. Atëherë ata do ta kuptojnë qartë se tek askush tjetër ata nuk mund të gjejnë strehim përveç All-llahut. Megjithatë, duke e parë se të kuptuarit e kësaj nuk ofron lehtësim për ta kjo vetëm sa do të shtojë telashet e tyre. Në atë ditë, ata do të grinden me njëri-tjetrin. Ndërkohë, ata pranojnë mëkatet e tyre. All-llahu e përshkruan këtë gjendje në vargjet në vazhdim:

**Ndërsa ndodhen aty brenda, ata do të grinden ndërmjet tyre, duke thënë: “Betohemi për All-llahun, ne kemi qenë njëmend në humbje të qartë, kur ju kemi barazuar me Zotin e botëve. Ishin të ligjtë ata që na mashtruan, Tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues (tek All-llahu) e as ndonjë mik të ngushtë! Ah, sikur të ktheheshim përsëri (në jetë) e të bëheshim besimtarë!” (Sure Shu’ara: 96-102)**

Siç tregohet në ajetet e mësipërme, duke ndjerë një keqardhje të thellë, jobesimtarët dëshirojnë të kthehen në dynja në mënyrë që të mund të angazhohen në vepra të mira që do t’iu sjellnin atyre mirësi në Ahiret. Megjithatë, kjo është një dëshirë e papranueshme. Ata e kuptojnë se, çkado që ata kishin ndjekur në dynja pasuria, bukuria, karriera, etj nuk kanë vlerë në Ahiret. All-llahu përshkruan disa nga shprehjet e tyre plot keqardhje në Kur’an:

**Por ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: “Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha**

qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!" (Do të thuhet) "Kapeni dhe lidheni në pranga, pastaj digjeni në zjarrin përvëlues, mandej lidheni në zinxhirë prej shtatëdhjetë kutësh, sepse ai, me të vërtetë, nuk ka besuar në All-llahun e Madhërishtëm dhe nuk është kujdesur për të ushqyer të varfrit e shkretë. Prandaj, ai sot këtu s'ka mik të afërt." (Sure Hakka: 25-35)

...Dhe, kur të sillet Xhehennemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç'i duhet se u kujtua! Ai do të thotë: "Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!" (Sure Fexhr: 23-24)

Përveç kësaj, të qenit dëshmitarë të gëzimit dhe lumturisë së madhe të banorëve të Xhennetit do ta thellojë edhe më shumë pendimin e jobesimtarëve. Ata e shohin dallimin e qartë në mes të jetës së banorëve të Xhennetit dhe jetës së tyre. All-llahu tërheq vëmendjen për dallimin në mes të banorëve të Xhennetit dhe të Zjarrit.

All-llahu e përshkruan pamjen e banorëve të zjarrit në Kur'an në këtë mënyrë:

**Të ulura do të jenë shikimet e tyre dhe do t'i mbulojë poshtërimi. (Sure Kalem: 43)**

**Kurse disa fytyra, atë Ditë, do të jenë të zymta. (Sure Kijame: 24)**

Në anën tjetër, All-llahu i përshkruan fytyrat e banorëve të Xhennetit si vijon:

**Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. (Sure Abese: 38-39)**

Mosbesimtarët nuk do të gjejnë ndonjë ushqim tjetër përveç ujit të valë, qelbit, gjembave të hidhura, dhe pemës së zekumit. Besimtarët, në anën tjetër, do të shpërblehen me lumenj prej qumështi dhe mjalti, pije të shijshme që shërbehen në gota, të gjitha llojet e frutave dhe gjithëçka që u dëshiron zemra. Në një ajet, All-llahu e përshkruan ushqimin e banorëve të Xhenetit si vijon:

**Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj All-llahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehennemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i valuar, që ua copton zorrët?! (Sure Muhammed: 15)**

Nuk ka dyshim se nuk mund të tërhiqen paralele në mes të këtyre mirësive që u janë dhuruar besimtarëve dhe ushqimit të jobesimtarëve, i cili nuk e shuan urinë e njeriut në asnjë mënyrë dhe që shndërrohet në një burim të përjetshëm të vuajtjes. Ata do të jenë të ekspozuar ndaj zjarrit aty për kohë shumë të gjatë, lëkurat e tyre do të përtërihen tek digjen, dhe ata do të luten për lehtësim dhe freskim. Ata do të jenë të etur për mirësitë që u janë dhuruar banorëve të Xhenetit që pushojnë nën hije dhe do të kërkojnë një pjesë të tyre për veten e tyre. Në Kur'an, Zoti ynë rrëfen për gjendjen e tyre si vijon:

**Banorët e zjarrit do t'u thërrasin banorëve të Xhenetit:**

**“Derdhni pak ujë te ne ose diçka nga ajo që ju ka dhuruar All-llahu!” Ata thonë: “Në të vërtetë, All-llahu këto i ka ndaluar për mohuesit, (Sure A’raf: 50)**

Thirrjet e atyre që nuk besuan nuk do të marrin përgjigje. All-llahu e pohon këtë në një ajet:

**...Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t’i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t’u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t’ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)! (Sure Kehf: 29)**

Gjithashtu, All-llahu do t’ju dhurojë Banorëve të Xhennetit veshje të gjelbërta prej mëndafshi të hollë dhe brokadë të pasur dhe byzylykë prej ari dhe argjendi. Ndërkohë, Banorët e Zjarrit do të kenë veshje prej katrani dhe zjarri të prera për ta. Besimtarët do të banojnë në banesa të bukura dhe dhoma të larta, të mbështetur në "kolltukë të kushtueshëm të thurrur," qilima elegant, dhe kolltukë të veshur me mbulesa të çmuara. Jobesimtarët, në anën tjetër, do të kenë Xhehennemin si vend pushimi dhe shtresa që i mbulojnë ata.

All-llahu na bën me dije në Kur’an se besimtarët do të kenë gjithëçka që ata dëshirojnë dhe Banorët e Xhennetit do të jenë të nderuar me një jetë të lumtur dhe të qetë në Xhennet.

**Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan. (Sure Shura: 22)**

**Por All-llahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim. (Sure Insan: 11)**

Po ta kishin marr jobesimtarët një qëndrim të ndërgjegjshëm,



të sinqertë dhe të ndershëm në dynja dhe në përputhje me urdhërat e All-llahut, ata nuk do t'i nënshtroheshin dënimit të Xhehennemit në atë Ditë. Kështu jobesimtarët do të ndjejnë një pendim edhe më të madh kur mendojnë për Banorët e Xhennetit. All-llahu e definon këtë dënim në Xhehennem dhe pendimin që ata ndjejnë si "vuajtje" dhe thekson se çdo përpjekje e tyre për të shpëtuar nga kjo vuajtje do të rezultojë me një dënim tjetër që e pason të mëparshmin:

**Sa herë, që do të përpiqen të dalin nga ankthi i zjarrit, do të rikthehen në të (e do t'u thuhet): "Shijoni dënimin me djegie të tmerrshme!" (Sure Haxhxh: 22)**

Kjo për arsye se Xhehennemi është një vend prej nga nuk ka kthim. Ai është vendi, ku ndjenja e pendimit nuk sjell asnjë përfitim për njeriun. Për më tepër, në Xhehennem, koncepti i pendimit nuk është i definuar. Në momentin që jobesimtarët vdesin, engjëjt do t'ju thonë atyre se ata kurrë më nuk do të përjetojnë diç të mirë për gjithë përjetësinë-përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe:

**Ditën, kur të shohin engjëjt, për keqbërësit nuk do të ketë lajm të mirë dhe do t'u thuhet: "Nuk do të kaloni dot për matanë!" (Sure Furkan: 22)**

Për këtë arsye, jobesimtarët e marrin shkatërrimin e vetes së tyre si mënyrën e vetme të shpëtimit. Ata do të luten për shkatërrimin e tyre, por pa dobi. Kjo për arsye se atyre u ishte dhënë një jetë e tërë, e cila ishte e mjaftueshme për të marrë mësim, por ata me dashje parapëlqyen mohimin dhe ia kthyen shpinën të

vërtetës. Si përgjigje ndaj kësaj, All-llahu do t'u thotë atyre si vijon:

**“Mos e kërkoni sot shkatërrimin vetëm një herë, por kërkoni shumë herë!” (Sure Furkan: 14)**

**“Përcëlluhuni në të! E duroni apo nuk e duroni, njësoj është për ju. Në të vërtetë, ky është shpërblimi i vetëm për atë që keni bërë”. (Sure Tur: 16)**

Në ajetin e dyzetë të Sures el-Araf, All-llahu e përshkruan ‘pamundësinë e jobesimtarëve’ për t'u larguar nga Xhehennemi dhe për të hyrë në Xhennet, duke thënë se "ata nuk do të hyjnë në Xhennet deri sa të kalojë deveja nëpër vrimën e gjilpërës." Për më tepër, All-llahu na njofton se jobesimtarët do të jenë të shpërfillur dhe të harruar pasi që, në dynja, ata ia kthyen shpinën rrugës së drejtë dhe e shpërfillën takimin e tyre të Ditës së Gjykimit. Ata nuk do të marrin asnjë përgjigje apo ndihmë nga All-llahu:

**(All-llahu) do t'i thotë: “Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.” (Sure Ta ha: 126)**

**Pastaj do t'u thuhet: “Ne sot po ju braktisim në harresë, ashtu siç e keni harruar ju takimin e kësaj dite. Vendqëndrimi juaj është Zjarri dhe për ju nuk ka kurrfarë ndihmësi. (Sure Xhathije: 34)**

**Të cilët e morën fenë për lojë dhe argëtim dhe u mashtruan nga jeta e kësaj bote”. Ne sot do t'i harrojmë ata, ashtu siç e patën harruar ata takimin e kësaj Dite dhe siç mohuan shpalljet Tona. (Sure A'raf: 51)**

Ata do t'i përgjërohen All-llahut për të shpëtuar nga zjarri dhe All-llahu do t'ju përgjigjet atyre kësisoj:

**“O Zoti ynë, nxirrma prej Xhehennemit e, nëse kthehemi prapë tek e keqja, atëherë jemi keqbërës të vërtetë.” Ai do t'u thotë: “Rrini aty të përbuzur dhe mos Më flisni asgjë!” (Sure Mu'minin: 107-108)**

Ata që nuk besuan do të marrin një dënim të ashpër. Ky dënim do të jetë qëndrimi në vetmi të plotë në vuajtje dhe mospranimi i asnjë ndihme. All-llahu nuk do të mëshirohet mbi ta, nuk do t'i mbrojë ata dhe nuk do t'i falë mëkatet dhe gabimet e tyre. Po të kishin kërkuar strehim tek All-llahu sa ishin të gjallë, do ta kishin gjetur All-llahun Gjithnjëfalës dhe Mëshirëplotë ndaj tyre. Megjithatë, me të hyrë në Xhehennem, këto fakte që do t'u vijnë në mendje më nuk do t'ju ndihmojnë atyre aspak.

Pas gjithë asaj që thamë, njeriu duhet të mendoj mbi disa fakte pikërisht tani: se All-llahu është plot mëshirë dhe dhembshuri ndaj robërve të Tij dhe se njeriu duhet ta bëjë vetëm All-llahun mik dhe mbrojtës të tij. Sepse pasi të mbyllen pas njeriut dyert e Xhehennemit, ato nuk do të hapen për aq kohë sa dëshiron All-llahu dhe nuk do të jepen më mundësi sikurse në këtë botë. Në Kur'an, All-llahu e përshkruan rrugën e shpëtimit si vijon:

**Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek All-llahu dhe që besimin e tyre e kanë sinqerisht vetëm për All-llahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë. All-llahu do t'u japë shpërblim të madh besimtarëve. Përse t'ju ndëshkojë All-llahu, nëse ju e falënderoni dhe e besoni?! All-llahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijsëm. (Sure Nisa': 146-147)**

# *Për të mos ndierë keqardhje në Ahiret*



*Përse t'ju ndëshkojë All-llahu, nëse ju e falënderont dhe e besont?! All-llahu është Mirënjohës dhe i Gjithëditshëm.  
(Sure Nisa': 147)*

Njerëzit janë krijuar me shumë dobësi dhe të meta. Gjatë gjithë jetës sonë, ne i harrojmë shumë gjëra dhe bëjmë gabime të panumërta. Megjithatë përmes pendimit, të cilin All-llahu na e dhuron si një nder të madh, gjithmonë është e mundur t'i korrigjojmë gabimet tona në këtë botë. Në të vërtetë, bota është krijuar vetëm për këtë qëllim: ne përgatitemi, vihem në sprovë, dhe pastrohemi nga gabimet tona në këtë botë. Është e mundur që ne të pendo kemi shumë për gabimet tona apo për mënyrën se si e kemi jetuar jetën tonë. Megjithatë, është gjithmonë e

mundur që ta kompensojmë këtë pendim. Pasi të kemi përjetuar këtë pendim, ne mund të lutemi për pranim të pendimit dhe të shpresojmë në faljen e All-llahut.

Në Kur'an, All-llahu jep lajmin e gëzuar se Ai do ta falë çdo gjynah nëse njeriu pendohet sinqerisht. All-llahu i di edhe mendimet tona më intime dhe çdo fjalë që ne e mbajmë në veten tonë. Ai e di nëse jemi apo nuk jemi të sinqertë ndaj Tij. All-llahu, në Kur'an, përshkruan afërsinë e Tij me robërit e Tij:

**Zoti juaj e di më së miri ç'keni në shpirtat tuaj. Nëse ju jeni të drejtë, sigurisht që Ai është Falës për ata që pendohen. (Sure Isra: 25)**

Megjithatë, një fakt tjetër i rëndësishëm del në sipërfaqe këtu; pas vdekjes, nuk është e mundur t'i kompensojmë gabimet dhe mëkatet e bëra në këtë botë përveç nëse All-llahu dëshiron ndryshe. Pra, ne nuk guxojmë të humbim as edhe një moment të vetëm. Minutat kalojnë sa hap e mbyll sytë dhe me çdo moment që kalon, ne i afrohem edhe më shumë vdekjes. Për më tepër, ne nuk mund të parashikojmë kurrë se kur do të përballemi me vdekjen. Koha, ora dhe minuta e saj s'mund të jenë të njohura kurrë. Ne të gjithë do të vdesim një ditë me siguri dhe do të japim llogari për veprat tona në Praninë e All-llahut.

Për këtë arsye, njeriu duhet gjithmonë të mbajë në mend se ai mund të vdes shpejt. Nëse nuk dëshiron të pendohet në botën tjetër, ai duhet ta rishikojë jetën e tij.

All-llahu është Krijuesi ynë i Gjithëfuqishëm dhe ajo

që i takon çdo individ i përballë Fuqisë së Tij është që të përmbush në mënyrë të duhur dhe të plotë obligimet e tij si rob gjatë kohës që i është dhënë atij në këtë botë. Një besimtar e dëshmon veten përmes kujdesit që ka ndaj rriteve fetare të tij; ai me entuziazëm kryen namazin 5 herë në ditë, abdestet dhe agjërimin e urdhëruar nga All-llahu gjatë gjithë jetës së tij.

Ibn 'Umari (ra)transmeton:

*Profeti (savs) ka thënë, "Feja e Islamit mbështetet në pesë parime themelore: të dëshmuarit se nuk ekziston Zot tjetër përveç All-llahut, se Muhammedi (savs) është rob dhe i Dërguar i Tij, namazi, zeqati, agjërimi dhe haxhillëku." (Buhariu dhe Muslimi)*

Po të ishte pikërisht tani koha për të takuar engjëjt e vdekjes, a do të ishte në gjendje një person i cili nuk arriti të përmbush detyrën e tij si rob i All-llahut në jetën e kësaj bote të jap llogari për të gjitha vitet që ka kaluar në këtë botë?

Çfarë keni bërë deri tani për të fituar kënaqësinë e All-llahut? A keni qenë mjaftë të përpiktë në përmbushjen urdhërave të All-llahut?

Një person mund të mos ketë një përgjigje pozitive për asnjërën nga këto pyetje. Por në qoftë se ai pendohet dhe me sinqeritet bën një zotim të padyshimtë që të jetojë për të fituar kënaqësinë e All-llahut, atëherë ai mund të shpresojë në faljen e All-llahut. I Dërguari i All-llahut (savs) shpesh ka kërkuar falje prej All-llahut:

*Pasha All-llahun, unë i kërkojë falje All-llahut dhe i kthehem*

*Atij me pendim çdo ditë më shumë se shtatëdhjetë herë.  
(Buhariu)*

Ne duhet të kërkojmë strehim tek All-llahu, i Cili është el-Gafar (Falësi, Ai i Cili është Gjithnjëfalës), el-Halim (i Buti, Ai i Cili është i Butë), dhe el-Teueb (Pranuesi i pendimit). All-llahu do t'i shpërblejë pa dyshim ata që janë të qëndrueshëm dhe që i drejtohen shpesh Atij. Ai me siguri do t'i fal robërit e Tij të cilët kanë besim dhe do t'i shpërblejë veprat e tyre të mira sipas më të mirës që kanë vepruar. Në Kur'an, All-llahu e shpall këtë lajm të madh të gëzuar si vijon:

**Gjithçka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek All-llahu, është e përhershme. Vërtet, Ne do t'i shpërblejmë ata që kanë duruar sipas veprave më të mira që kanë bërë. Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë. (Sure Nahl: 96-97)**

I Dërguari i All-llahut (savs) gjithashtu u bëri thirrje besimtarëve që të jenë të durueshëm në bërjen e veprave të mira dhe u dha atyre lajmin e mirë se ata do të shpërblehen nga All-llahu, nëse veprojnë kështu:

*Profeti (savs) ka thënë: "Vazhdoni të bëni (vepra të mira), ngase çdo njeri do ta ketë të lehtë të bëjë (atë që do ta shpijë atë në vendin e tij të përcaktuar)." Pastaj ai recitoi: "Sa për atë që jep (lëmoshë) nga pasuria e tij dhe përmbush obligimin e tij ndaj All-*



*llahut, dhe beson në shpërblimin më të mirë nga All-llahu (All-llahu pra do ta shpërblejë atë për atë që ai do të shpenzojë në rrugën e All-llahut). Pra, Ne do ta sheshojmë për të rrugën e lehtësisë. Por ai i cili është një koprrac i pangopur ... për të, rrugën e të keqes. " (Buhariu)*

Kurrë mos harroni se në çdo kohë çdonjërit prej nesh mund t'i vijë vdekja dhe, edhe pse mund të jetë i penduar shumë, mund të mos ketë më mundësi për t'i korrigjuar gabimet e bëra në jetën e kësaj bote. Për këtë arsye, nuk duhet të humbasin fare kohë dhe të kërkojmë pranimin e pendimit nga All-llahu dhe të jetojmë sipas urdhërave të Tij dhe sipas sunnetit të Pejgamberit (savs). Kjo është e mënyra e vetme për të qenë rob mbi të cilin All-llahu derdh mëshirën dhe dashurinë e Tij. Kjo është përsëri e vetmja mënyrë për të fituar Xhennetin, vendbanimin e përjetshëm që All-llahu e ka përgatitur për besimtarët e Tij të sinqertë.

# *Mashtrimi i evolucionit*



Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të Krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të rregullit të mrekullueshëm në gjithësi dhe në gjallesa, si edhe me anë të zbulimit të rreth 300 milion fosileve që zbulojnë se evolucionit nuk ka ndodhur kurrë. Në këtë mënyrë, shkencë vërtetoi faktin se All-llahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda që zhvillohet sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se **teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës** ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e

Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme si biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darvinizmit dhe e përdorin faktin e krijimit për ta shpjeguar zanafillën e jetës.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

### Dështimi shkencor i Darvinizmit

Teoria e evolucionit, si **një doktrinë pagane** që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit *Origjina e Llojeve të Çarls Darvinit*. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. **Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një "supozim".** Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar *"Vështirësitë e Teorisë"*, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

## **Pengesa e parë e pakapërcyeshme:**

### **Zanafilla e jetës**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: **Si u krijua kjo “qelizë e parë”?**

**Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyreshme, ajo supozon se “qeliza e parë”**

është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

### "Jeta rrjedh nga jeta"

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. **Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që sillleshin nga mizat.**

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster

shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: **“Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”**<sup>1</sup>

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkencë, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

### **Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet**

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohet rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.<sup>2</sup>

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar

gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

**Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohet se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.<sup>3</sup>**

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.<sup>4</sup>

**Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses.** Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth", pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?<sup>5</sup>*

### **Ndërtimi i ndërlikuar i jetës**

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë



njeriu. **Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.**

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës Scientific American të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të

jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.<sup>6</sup>

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijuar” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

### **Mekanizmat imagjinarë të evolucionit**

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sig-

urisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, **mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet**, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.*<sup>7</sup>

### **Ndikimi i Lamarkut**

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij *Origjina e Llojeve*, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.<sup>8</sup>

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të

trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

### **Neo-darvinizmi dhe mutacionet**

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: **ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlëkuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj.** Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si

në vazhdim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.<sup>9</sup>*

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se **nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë.** Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

### **Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sug-

jerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

**Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:**

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë

ekzistuar me siguri... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”<sup>10</sup>

Megjithatë, **Darvini ishte më se i vetëdijshëm se ende nuk ishin gjetur fosile të këtyre formave të ndërmjetme.** Ai e konsideronte këtë si pengesë madhore për këtë teori. Në një kapitull të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë,” ai shkroi:

**Përse, nëse llojet kanë prejardhje nga llojet tjera përmes ndryshimeve delikate graduale, nuk shohim gjithandej forma të panumërta kalimtare? Përse nuk është e gjithë natyra në rrëmujë në vend se llojet të jenë, siç i shohim, të definuara mirë? ... Por, pasi që sipas kësaj teorie duhet të kenë ekzistuar forma të panumërta kalimtare, përse nuk i gjejmë ato të ngulitura në koren e tokës? ... Përse atëherë nuk është çdo formacion gjeologjik dhe çdo shtresë përplot me hallka të tilla kalimtare? Gjeologjia sigurisht nuk zbulon çfarëdo zinxhiri të tillë organik të shkallëzuar në mënyrë të përsosur; dhe kjo, mbase, është kundërshtimi më i dukshëm dhe më serioz që mund t’i bëhet teorisë sime.<sup>11</sup>**

### **Shpresat e venitura të Darvinit**

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, **ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare.** Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se **jeta në Tokë u shfaq krejt papritur dhe plotësisht e formuar.**



Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.<sup>12</sup>*

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që të gjitha gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plot-fuqishëm.<sup>13</sup>

**Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer.** Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por **Krijimi**.

## Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore. 14

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe

përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”<sup>15</sup>

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.<sup>16</sup>

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. **Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.**<sup>17</sup>

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhën) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.<sup>18</sup>

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po

mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijuar nga imajinuarë “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër **veçse një mit pa asnjë bazë shkencore**.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitëkut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e jashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

*Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën*

*kohë.19*

**Përralla e evolucionit njerëzor** nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

### **Formula e Darvinit!**

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

*Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomev nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin*

**“formula e Darvinit”:**

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magnezi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte

normale, por që ata mendojnë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepja, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallonj, fazanë, flutura shumëngjyreshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilëso prej tyre.

Thënë shkurt, **atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën** duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. **Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të All-llahut.**

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

### **Teknologjia e syrit dhe veshit**

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

**Truri është i izoluar tërësisht nga drita.** Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

**Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë.** Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me

të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër.

Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se **syri nuk mund të jetë formuar rastësisht**, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brend-



shëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. Do të thotë, **truri është i izoluar nga tingujt**, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të **mprehtë perceptohen nga truri**. Në trurin tuaj, **i cili është i izoluar nga tingujt, ju dëgjoni simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz**. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë.

Kështu ka qenë gjithmonë që nga **krijimi i njeriut**.

Deri më sot, asnjë aparat vizual apo regjistruer i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, për sa i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

### **Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? **Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë.** Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse **kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej All-llahut**, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për

trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për All-llahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

### **Një besim materialist**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se **teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore**. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se **format e nevojshme kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë**. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja është se kjo teori është situatë të krijuar është një besim dogmatik i domosdoshëm për disa qarqe. Këto qarqe janë verbërisht besnike ndaj filozofisë materialiste dhe e pranojnë darvinizmin sepse ai është shpjegimi i vetëm materialist që mund të prezantohet për të shpjeguar funksionimin e natyrës.

Është mjaft interesant fakti se ata e pranojnë këtë fakt po ashtu kohë pas kohe. Një gjeneticist i mirënjohur dhe evolucionist i hapur, Richard C. Lewontin nga Univerziteti i Harvardit, pranon se ai është “në radhë të parë një materialist dhe më pas një shkencëtar”:

*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë një [ndërrhyrje] Hyjnore...20*

Këto fjalë janë deklarata të qarta se **Darvinizmi është një dogmë** e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona lloje të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që të mos pranojnë, në sytë e tyre ekzistencën e Allahut.

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: **të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili**

zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është All-llahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstrukttoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

### **Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimeve dhe ndikimit të çfarëdo lloj ideologjie, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sebes, adhurimi i idhujve që kishin mbaru-

ar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, All-llahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kur'an. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

**Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. All-llahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Surja Bekare: 6-7)**

**...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit. (Surja A'raf: 179)**

**Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Surja Hixhr: 14-15)**

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se

atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kur'ani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

**“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Surja A'raf: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrorjmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

**Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Surja A'raf: 117-118)**

Siç mund të shohim, kur njerëzit e kuptuan se ata kishin qenë të magjepsur dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën tërë besueshmërinë. Edhe në ditët tona po ashtu, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake dhe

kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato nën maskën e tyre shkencore, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur të shfaqet e vërteta e plotë dhe magjia të prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, i cili ishte një ateist që mbrojti teorinë e evolucionit për rreth 60 vite, por i cili më pas e kuptoi të vërtetën, zbulon pozitën në të cilën do të gjendet teoria e evolucionit në të ardhmen e afërt me këto fjalë:

*Unë personalisht jam i bindur se **teoria e evolucionit**, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, **do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen**. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo përmban.<sup>21</sup>*

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashttrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

---

*(Engjëjt) Thanë: “Ti je i pa të meta,  
ne kemi dije tjetër përveç atë që na mësove Ti.*

*Vërtetë, Ti je i gjithdijshëm, i urt!*”

*(Sura El Bekare, 32)*

---



## SHËNIMET

1. Sidney Fox, Klaus Dose, Evolucioni Molekular dhe Origjina e Jetës, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, f. 4.
2. Alexander I. Oparin, Origjina e Jetës, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (ribotim), f. 196.
3. "Dëshmi të reja mbi evolucionin e atmosferës dhe të jetës së hershme", Buletini i Shoqatës Meteorologjike Amerikane, vëll 63, nëntor 1982, f. 1328-1330.
4. Stanley Miller, Evolucioni Molekular i Jetës: Statusi aktual i Sintezës Prebiotike të molekulave të vogla, 1986, f. 7.
5. Jeffrey Bada, Earth, shkurt 1998, f. 40.
6. Leslie E. Orgel, "Origjina e Jetës në Tokë", Scientific American, vol. 271, tetor 1994, f. 78.
7. Charles Darwin, Origjina e llojeve nëpërmjet selektimit natyror, Modern Library, New York, f. 127.
8. Charles Darwin, Origjina e llojeve: Një Faksimil i botimit të parë, Shtypi i Universitetit të Harvardit, 1964, f. 184.
9. B.G. Ranganathan, Origjinat?, Pensilvani: The Banner Of Truth Trust, 1988, f. 7.
10. Charles Darwin, Origjina e llojeve: Një Faksimil i botimit të parë, 1964, f. 179.
11. Charles Darwin, Origjina e llojeve, f. 172.
12. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record," Proceedings of the British Geological Association, vol 87, 1976, p. 133.
13. Douglas J. Futuyma, Shkenca në sprovë, Pantheon Books, New York, 1983. faqe 197.
14. Solly Zuckerman, Matanë Kullës së Fildishtë, Toplinger Publications, New York, 1970, fq 75-94; Charles E. Oxnard, "Pozita e Australopitekut në Evolucionin Njerëzor: Bazë për Dyshime", Nature, vëll 258, fq 389.
15. "A ka mundësi që shkencës t'i vijë fundi me besimin e shkencëtarëve se ata kanë përgjigjet përfundimtare apo nga ngurrimi i shoqërisë për të paguar faturat?" Scientific American, Dhjetor 1992, f. 20.
16. Alan Walker, Science, vëll 207, 7 mars 1980, f. 1103; A.J. Kelso, Antropologjia Fizike, botimi i 1rë, J.B. Lipincott Co., New York, 1970, f. 221; M. D. Leakey, Olduvai Gorge, vëll. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, f. 272.
17. Jeffrey Kluger, "Megjithatë jo aq të zhdukur: Homo Erektusi primitiv mund të ketë mbijetuar aq gjatë sa të bashkëjetoj me njerëzit modern," Time, 23 dhjetor 1996.
18. S. J. Gould, Historia e Natyrës, vëll. 85, 1976, f. 30.
19. Solly Zuckerman, Matanë Kullës së Fildishtë, f. 19.
- 20 - Richard Lewontin, " Bota e përndjekur prej demonëve," New York Review of Books, 9 janar 1997, f. 28.
- 21- Malcolm Maggeridge, Fundi i

# HARUN YAHYA.TV ON THE INTERNET

<http://en.harunyahya.tv/>



You can watch live lectures of Mr. Adnan Oktar with English simultaneous translation everyday between 22.00-02.00 (GMT+2) on [en.HarunYahya.tv](http://en.HarunYahya.tv). This site also contains the latest interviews given by Mr. Oktar to the Turkish and international media, together with selected highlights from a wide range of earlier interviews covering faith-related, political and other issues. It also provides readers with the opportunity to down-


load podcasts by the author for direct listening or transfer to MP3 players and the like. Another feature of the site is that it brings the author's renowned documentaries together for download or easy watching, together with audio recordings. Many of these features are available in a wide range of other languages easily accessible from the main pages.

## HARUN YAHYA ON iphone, ipod & ipad












<http://itunes.apple.com/tr/app/harun-yahya/id382003103?mt=8>










You can review the all works of Mr. Adnan Oktar via this application in many different languages.









- Books
- Movies
- Audios
- Web sites
- Articles
- Magazines
- Harun Yahya's Influences
- Announcements
- Daily Comments

# ALSO BY HARUN YAHYA












# CHILDREN'S BOOKS



# HARUN YAHYA ON THE INTERNET



www.harunyahya.com

YOU CAN PURCHASE HARUN YAHYA'S BOOKS FROM THIS SITE!



[www.islamdenouncesterrorism.com](http://www.islamdenouncesterrorism.com)



[www.bookglobal.net](http://www.bookglobal.net)



[www.turkishislamicunion.com](http://www.turkishislamicunion.com)



[www.unionoffaiths.com](http://www.unionoffaiths.com)




[www.fossil-museum.com](http://www.fossil-museum.com)



[www.jesusswillreturn.com](http://www.jesusswillreturn.com)



[www.islamdenouncesantisemitism.com](http://www.islamdenouncesantisemitism.com)



[www.awaitedmahdi.com](http://www.awaitedmahdi.com)





[www.replytowikipedia.com](http://www.replytowikipedia.com)



[www.mahdinevershedsblood.com](http://www.mahdinevershedsblood.com)



[www.qurandeniesdarwinism.com](http://www.qurandeniesdarwinism.com)



[www.paradiseinthequran.com](http://www.paradiseinthequran.com)

## OTHER SITES:

- [www.signsofcreation.com](http://www.signsofcreation.com)
- [www.darwinismthegreatestlieinhistory.com](http://www.darwinismthegreatestlieinhistory.com)
- [www.truthofthisworld.com](http://www.truthofthisworld.com)
- [www.endoftimes.net](http://www.endoftimes.net)
- [www.creationofman.net](http://www.creationofman.net)
- [www.islamandkarma.com](http://www.islamandkarma.com)
- [www.eastturkestan.com](http://www.eastturkestan.com)
- [www.signsofthelastday.com](http://www.signsofthelastday.com)
- [www.darwinistsneverrealize.com](http://www.darwinistsneverrealize.com)
- [www.loveofallah.com](http://www.loveofallah.com)
- [www.adnanoktarinterviews.com](http://www.adnanoktarinterviews.com)
- [www.whatisdestiny.com](http://www.whatisdestiny.com)
- [www.dailycomments.net](http://www.dailycomments.net)
- [www.skulldemolishdarwinism.com](http://www.skulldemolishdarwinism.com)
- [www.returningtofaith.com](http://www.returningtofaith.com)
- [www.religionofdarwinism.com](http://www.religionofdarwinism.com)

- [www.thestoneage.org](http://www.thestoneage.org)
- [www.paradiseinthequran.com](http://www.paradiseinthequran.com)
- [www.dayofjudgment.com](http://www.dayofjudgment.com)
- [www.servingislam.com](http://www.servingislam.com)
- [www.theprophetjesus.com](http://www.theprophetjesus.com)
- [www.theprophetmuhammad.org](http://www.theprophetmuhammad.org)
- [www.palestiniantragedy.com](http://www.palestiniantragedy.com)
- [www.miraclesofthequran.com](http://www.miraclesofthequran.com)
- [www.theislamicunion.com](http://www.theislamicunion.com)
- [www.qurandeniesdarwinism.com](http://www.qurandeniesdarwinism.com)
- [www.truthofthisworld.com](http://www.truthofthisworld.com)
- [www.nightmareofdisbelief.com](http://www.nightmareofdisbelief.com)
- [www.creationofuniverse.com](http://www.creationofuniverse.com)
- [www.darwinism-watch.com](http://www.darwinism-watch.com)
- [www.evolutiontale.com](http://www.evolutiontale.com)
- [www.evolutionisnotscientific.com](http://www.evolutionisnotscientific.com)
- [www.atheismrefuted.com](http://www.atheismrefuted.com)
- [www.antiantichrist.org](http://www.antiantichrist.org)



# HARUN YAHYA DOCUMENTARIES ON DVD & VCD

## 40 Pcs. DVDs Documentary Film Set



[DVDs]:

- 1- The Creation of the Universe
- 2- The Secret Beyond Matter
- 3- Miracles of the Qur'an
- 4- The Miracle of Man's Creation
- 5- Perished Nations - I
- 6- Allah's Artistry in Color
- 7- Islam Denounces Terrorism
- 8- The Qur'an Leads the Way to Science
- 9- The Signs of the Last Day
- 10- The Truth of the Life of This World
- 11- The Secret of the Test
- 12- The Bloody History of Communism I
- 13- The Bloody History of Communism II
- 14- The Fact of Creation
- 15- The Miracle in the Ant
- 16- The End Times and the Mahdi
- 17- Love and Cooperation in Living Things
- 18- The Miracle Planet - I
- 19- Splendour in the Seas
- 20- Perished Nations -II
- 21- Allah is Known Through Reason
- 22- Deep Thinking
- 23- For Men of Understanding -I
- 24- For Men of Understanding -II
- 25- For Men of Understanding -III
- 26- Miracles of the Brain : Smell and Taste
- 27- The Miracle in the Cell
- 28- Behind the Scenes of the World Wars
- 29- Answers from the Qur'an
- 30- The Collapse of the Theory of Evolution
- 31- The Collapse of Atheism
- 32- The Disasters Darwinism Brought to Humanity
- 33- Altruism in Nature
- 34- The Miracle of Seed
- 35- Biomimetics: Technology Imitates Nature
- 36- The Names of Allah
- 37- Satanism: Satan's Bloody Teaching
- 38- The Miracle of Respiration
- 39- Solution: The Values of the Qur'an
- 40- The Miracle Planet II

## 10 Pcs. DVDs

### Multi Language DVD Set



- 1- The Signs of the Last Day
- 2- The Truth of the Life of This World
- 3- Allah Is Known Through Reason
- 4- Deep Thinking
- 5- Allah's Artistry In Color
- 6- The Fact of Creation
- 7- For Men of Understanding-I
- 8- For Men of Understanding-II
- 9- For Men of Understanding-III
- 10- Love and Cooperation in Living Things

## 20 Pcs. VCDs

### For Men of Understanding Documentary Series VCDs



- VCD1: The End Times and Mahdi  
Technology in Nature
- VCD2: The Miracle of Seed  
Miracles of the Brain:Smell and Taste
- VCD3: Perished Nations-I  
Perished Nations-II
- VCD4: The Truth of the Life of This World  
Solution: The Values of the Qur'an
- VCD5: Architects in Nature  
Allah Is Known Through Reason
- VCD6: Allah's Artistry in Color  
Love and Cooperation in Living Things
- VCD7: The Creation of the Universe  
The Miracle Planet
- VCD8: Behind the Scenes of the World Wars  
The Miracle of Respiration
- VCD9: Signs of the Last Day  
The Miracle in the Ant
- VCD10: The Miracle in the Cell  
Deep Thinking